

# 4You magazine

Revistë mujore e KFOR-it Nr. 199 - Shtator 2023

KFOR КФОР

www.magazineforyou.com

4You Magazine - Shqip

magazine4ushqip

radio K4

• 90.2 • 96.6 •
www.radiokfor.com

MUSICBOX

## TEUTË HALILI

Falas

4You magazine

"4You Magazine" është publikim zyrtar i KFOR-it, prodhuar dhe financuar nga KFOR-i, i shtypur në Kosovë dhe shpërndahet pa pagesë. Përmbajtja nuk reflekton qëndrimin zyrtar të koalicionit apo të shteteve anëtare. KFOR-i pranon edhe i mirëpret opinionet tuaja dhe i publikon ato, por në formë të përmbledhur. Nëse kërkohet emri i autorit të mos tregohet, kjo mund të bëhet, por nuk do të publikohen letra anonime, shpifëse apo me qëllim të keq.

**Kryeredaktore:** Leonora Shabanaj Nikshiq
**Gazetarë:** Ali Rexha, Violeta Matovic, Jelena Simic Rasic
**Fotografitë:** Ekipi "4You"
**Design & Layout:** Bekim Shabani & Leopard Cana

Stafi editorial mund të kontaktohet në telefon:
**038/503-603-2139**
Letrat mund të dërgohen në adresën:
**HQ KFOR - Kosova Film;**
**"4You Magazine";**
**Strasbourg Building;**
**10000 Prishtinë**

E-mail:
**magazineforyou2003@gmail.com**
**www.magazineforyou.com**




*Kopertina: Teutë Halili*

# Editorial

***Pas asaj që rezultoi të ishte një prej verave më të ngrohta që e kemi përjetuar viteve të fundit, erdhi koha për t'u kthyer në shkollë. Me përjashtim të parafillorëve dhe disave që e fillojnë klasën e parë, ju të tjerët "e dini se çka do të thotë kjo". Prandaj, kjo nuk është një përvojë tërësisht e re. Sidoqoftë, ky është një vit i ri shkollor, dhe ju gjithmonë mund të bazoheni dhe t'i përmirësoni përvojat e së kaluarës për të arritur rezultate maksimale. Natyrisht, ju të gjithë e keni mënyrën tuaj për t'u përgatitur për vitin para jush, mirëpo në vijim do ta gjeni një listë të dobishme të gjërave që mund t'i bëni për t'u përgatitur më së miri për këtë aventurë të re.***

***Vendosni qëllime të qarta:*** *Përcaktoni qëllime specifike akademike dhe personale për vitin. Kjo mund të përfshijë arritjen e notave të caktuara, përmirësimin në lëndë specifike, regjistrimin në aktivitete jashtëshkollore ose zhvillimin e aftësive personale.*

***Përgatitni hapësirën tuaj për mësim:*** *Krijoni një hapësirë për mësim të pastër dhe të organizuar në shtëpi, e cila është e lirë nga shpërqendrimet dhe e favorshme për të mësuar. Të kesh një zonë të dedikuar për të mësuar do të ndihmojë përqendrimin dhe produktivitetin.*

***Krijoni një orar për mësim:*** *Zhvilloni një orar mësimi ditor ose javor që ua mundëson ndarjen e ekuilibruar të kohës midis mësimit, aktiviteteve jashtëshkollore dhe kohës personale. Përmbajuni orarit sa më shumë që të jetë e mundur.*

***Rishikoni materialin e vitit të kaluar:*** *Kaloni pak kohë duke i rishikuar konceptet kryesore nga viti i kaluar. Kjo do t'ju ndihmojë të ndërtoni një bazë solide për temat dhe lëndët e reja.*

***Planifikoni përpara:*** *Sigurojeni një kopje të planprogramit ose syllabusit të secilës lëndë, nëse është e mundur, dhe shënoni datat e rëndësishme si provimet, afatet e projekteve dhe aktiviteteve. Kjo do t'ju ndihmojë të qëndroni të organizuar dhe të planifikoni kohën tuaj në mënyrë efektive.*

***Krijoni një përcjellës të qëllimeve:*** *Mbani një ditar ose përdorni një aplikacion për të përcjellë përparimin tuaj drejt qëllimeve tuaja akademike dhe personale. Rishikoni dhe rregulloni rregullisht strategjitë tuaja bazuar në përparimin tuaj.*

***Praktikoni menaxhimin e kohës:*** *Mësoni teknika efektive të menaxhimit të kohës për të balancuar shkollën, programet jashtëshkollore dhe jetën personale. Shmangni zvarritjen dhe* ***jepuni përparësi detyrave në bazë të afateve dhe rëndësisë.***

***Regjistrohuni në klube ose organizata:*** *Shqyrtojini mundësitë që t'iu bashkoheni klubeve, organizatave ose ekipeve sportive që përputhen me interesat tuaja. Kjo është një mënyrë e shkëlqyer për të bërë miq të rinj dhe për të përmirësuar aftësitë tuaja.*

***Qëndroni të shëndetshëm:*** *Mbani një dietë të ekuilibruar, bëni stërvitje të rregullta dhe sigurohuni që të keni gjumë të mjaftueshëm çdo natë. Një trup dhe mendje e shëndetshme janë thelbësore për suksesin akademik.*

***Qëndroni të informuar:*** *Përditësohuni me çdo ndryshim ose njoftim të rëndësishëm nga administrata e shkollës. Kontrolloni rregullisht emailet e shkollës ose faqet e internetit.*

***Praktikoni vetë-kujdesin:*** *Bëni pushim kur është e nevojshme, përfshihuni në hobi ose aktivitete që ju pëlqejnë dhe praktikoni teknikat e përqendrimit ose relaksimit për të menaxhuar stresin.*

***Bëhuni pozitiv:*** *Qasuni vitit të ri me një qëndrim pozitiv. Besoni në veten tuaj, qëndroni optimistë dhe mbani mend se çdo sfidë është një mundësi për rritje.*

***Në fund, mbani mend, është thelbësore të jeni fleksibil dhe të hapur ndaj përshtatjeve gjatë gjithë vitit. Të kesh një fillim të fortë me një plan të organizuar mirë do t'ju vendosë në rrugën drejt suksesit.***
***Ju urojmë fat të mbarë!***

Leonora

# Indeksi




*2.* ***Editoriali, indeksi***
*4.* ***Shkolla e muajit:*** SHFMU "GJ. K. SKENDERBEU"
*6.* DEZINFORMATAT: RËNDËSIA E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT
*8.* ***Music Box:*** TEUTË HALILI: KËNGËTARJA E RE SYPATREMBUR NË SKENËN TONË MUZIKORE!
*12.* DEFY THEM: BASHKIMI I KOMUNITETIT PËRMES MUZIKËS DHE ARTIT
*14.* ***World around Us:*** TË NJIHEMI ME PESË UNIVERSITETET KULMORE NË BOTË
*16.* ***Do it Yourself:*** SI TA BËJMË NJË ÇANTË UNIKE TË LAPSAVE PËR SHKOLLË?
*18.* ***Moviemania:*** KREMTIMI I KINEMASË SË PAVARUR: FESTIVALI I FILMIT "SUNDANCE"
*20.* ***Health & Sports:*** AMIR RRAHMANI: YLLI NË NGRITJE NË GALAKSINË E FUTBOLLIT
*22.* ***Generation#:*** SYZET ZMADHUESE INTELIGJENTE TË APPLE PËR EKSPLORIM: ÇKA DIMË DERI TASH
*24.* DOKUFEST DHE PROJEKTI "SI TË SHOH TY" - LIDHJA PËRMES ARTIT DHE KULTURËS NË BALLKAN
*26.* ***Your opinion about:*** MENDIMI JUAJ PËR PEMËT?
*28.* ***Wellbeing & teens:*** SFIDAT DHE MUNDËSITË TË CILAT I SJELL SHTATORI DHE VITI I RI SHKOLLOR
*30.* ***Brainteasers:*** KËNDI ENIGMATIK
*32.* ***Did you know?*** ARSIMI

# Editorial

***After what turned out to be one of the hottest summers we have experienced in recent years, the time has come to go back to school. Except, for preschoolers and some of first graders you have already "been there done that". So, this is not a completely new experience. However, it is a new academic year, and you can always build and improve on your past experiences to get the maximum results. Of course, you all have your way of preparing for the year ahead, but below you will find a useful list of things you can do to best prepare for your new adventure.***

***Set Clear Goals:*** *Define specific academic and personal goals for the year. This could include achieving certain grades, improving in specific subjects, joining extracurricular activities, or developing personal skills.*

***Prep Your Study Space:*** *Set up a clean and organized study space at home that is free from distractions and conducive to learning. Having a dedicated area to study will help focus and productivity.*

***Create a Study Schedule:*** *Develop a daily or weekly study schedule that allows for balanced time allocation between academics, extracurricular activities, and personal time. Stick to the schedule as much as possible.*

***Review Last Year's Material:*** *Take some time to review the key concepts from the previous year. This will help you build a solid foundation for new topics and subjects.*

***Plan Ahead:*** *Get a copy of the syllabus or course outline for each subject, if available, and mark important dates such as exams, project deadlines, and events. This will help you stay organized and plan your time effectively.*

***Set Up a Goal Tracker:*** *Keep a journal or use an app to track your progress toward your academic and personal goals. Regularly review and adjust your strategies based on your* ***progress.***

***Practice Time Management:*** *Learn effective time management techniques to balance school, extracurriculars, and personal life. Avoid procrastination and prioritize tasks based on deadlines and importance.*

***Join Clubs or Organizations:*** *Consider joining clubs, organizations, or sports teams that align with your interests. It's a great way to make new friends and enhance your skills.*

***Stay Healthy:*** *Maintain a balanced diet, get regular exercise, and ensure you have enough sleep each night. A healthy body and mind are essential for academic success.*

***Stay Informed:*** *Keep yourself updated with any changes or important announcements from the school administration. Check school emails or websites regularly.*

***Practice Self-Care:*** *Take breaks when needed, engage in hobbies or activities you enjoy, and practice mindfulness or relaxation techniques to manage stress.*

***Be Positive:*** *Approach the new year with a positive attitude. Believe in yourself, stay optimistic, and remember that every challenge is an opportunity for growth.*

***Finally, remember, it's essential to stay flexible and open to adjustments throughout the year. Having a strong start with a well-organized plan will set you on the path to success. We wish you good luck!***

*Leonora*

# Index





*3.* ***Editorial, index***

*5.* ***School of the month:*** EJHS "GJ. K. SKENDERBEU"

*7.* DISINFORMATION: THE IMPORTANCE OF VERIFYING THE INFORMATION

*9.* ***Music Box:*** TEUTË HALILI: THE NEW FEARLESS SINGER IN OUR MUSIC SCENE!

*13.* DEFY THEM: UNITING COMMUNITIES THROUGH MUSIC AND ART

*15.* ***World around Us:*** LET'S GET TO KNOW TOP FIVE UNIVERSITIES IN THE WORLD!

*17.* ***Do it Yourself:*** HOW TO MAKE A UNIQUE PENCIL CASE FOR SCHOOL?

*19.* ***Moviemania:*** CELEBRATING INDEPENDENT CINEMA: THE SUNDANCE FILM FESTIVAL

*21.* ***Health & Sports:*** AMIR RRAHMANI: RISING STAR IN THE FOOTBALL GALAXY

*23.* ***Generation#:*** EXPLORING APPLE'S AUGMENTED REALITY SMART GLASSES: WHAT WE KNOW SO FAR

*25.* DOKUFEST AND "HOW I SEE YOU" PROJECT - CONNECTION THROUGH ART AND CULTURE IN THE BALKANS

*27.* ***Your opinion about:*** YOUR OPINION ABOUT FRUITS?

*29.* ***Wellbeing & teens:*** CHALLENGES AND OPPORTUNITIES BROUGHT BY SEPTEMBER AND NEW SCHOOL YEAR!

*31.* ***Brainteasers:*** CROSSWORD PUZZLES

*32.* ***Did you know?*** EDUCATION



4You magazine

"4You Magazine" is an official publication of KFOR, produced and financed by KFOR, printed in Kosovo and distributed freely. The contents do not necessarily reflect the official point of view of the coalition or that of any of its member states. KFOR accepts and welcomes your opinions, it will publish some of these, eventually in a condensed form. If requested the name of the writer will be withheld but no anonymous, defamatory or malicious letters will be printed.

**Chief Editor:**
Leonora Shabanaj Nikshiq
**Journalists:** Ali Rexha, Violeta Matovic, Jelena Simic Rasic
**Photos by:** "4You" Team
**Design & Layout:**
Bekim Shabani & Leopard Cana

The editorial staff can be contacted on:
**038/503-603-2139**
Any letters can be sent at:
**HQ KFOR - Film City;**
**"4You Magazine";**
**Strasbourg Building;**
**10000 Pristina**

E-mail:
**magazineforyou2003@gmail.com**
**www.magazineforyou.com**





*Cover:*
*Teutë Halili*

# SHFMU "GJ. K. SKËNDERBEU" SALLAGRAZHDË

*Ambienti i gjelbëruar, pastërtia dhe rregulli janë tri gjërat e para që bien në sy sapo të futesh në oborrin e Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët (SHFMU) "Gj. K. Skënderbeu" në fshatin Sallagrazhdë. Fakti se shkolla gjendet në një fshat i cili shtrihet rrëzë bjeshkëve të Sharrit vetëm sa ia shton hijeshinë këtij objekti të dijes. Përshtypjet e mira vazhdojnë edhe brenda shkollës. Drejtori i kësaj shkolle z. Bafti Gashi, tregon se gjithçka në këtë shkollë është arritur në rend të parë falë punës dhe angazhimit të pakursyer të mbarë kolektivit të shkollës, mirëpo, pa i harruar edhe prindërit e sidomos vet nxënësit.*





**z. Bafti Gashi - drejtor**

### Të gjitha nismat pozitive kanë lindur prej nxënësve

Sipas drejtorit të shkollës, shkaku kryesor i suksesit të tyre është bashkëpunimi që personeli, qoftë ai administrativ apo mësimor, e kanë krijuar me nxënësit përgjatë viteve të funksionimit të saj. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, organet shkollore si këshilli i nxënësve apo ai prindërve janë shumë aktiv. "Bashkëpunimi është në nivel aq të mirë sa që do të thosha se të gjitha nismat pozitive kanë lindur prej nxënësve por, ç' është më e rëndësishme edhe janë realizuar, së paku pjesërisht, nga vetë nxënësit. Nga ana tjetër, fakti se idetë kanë ardhur dhe janë realizuar nga vetë fëmijët, ka ndikuar që ata të bëhen mbrojtësit kryesor të mjedisit shkollor," deklaroi drejtori Gashi. Ai vazhdoi më tej duke theksuar se fryma e bashkëpunimit në këtë shkollë është e një rëndësie tepër të veçantë. "Rreth tridhjetë për qind e banorëve të Sallgrazhdës i përkasin besimit katolik. Kjo do të thotë se në këtë shkollë mësimet i vijojnë nxënësit e besimeve të ndryshme fetare. Përkundër kësaj, ne asnjëherë nuk kemi pasur probleme për shkak të këtyre dallimeve as në shkollë, por as në fshatin tonë."

### Falë investimeve ndër vite shkolla është në gjendje të mirë

Edhe sa i përket gjendjes së objektit shkollor, drejtori Gashi tha se falë projekteve të ndryshme që janë realizuar deri tani, objekti i shkollës është në një gjendje mjaft të mirë dhe i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimit. Për shembull, disa vite më parë, falë një projekti të realizuar nga Komisioni Evropian, në këtë shkollë asokohe u investuan rreth 300.000 euro, për izolimin dhe lyerjen e tërësishme të shkollës, rregullimin e kulmit si dhe vendosjen e sistemit të ngrohjes qendrore. Një investim tjetër i çmuar, për të cilin tashmë kemi shkruar në revistën tonë, u realizua vetëm disa muaj më parë nga CIMIC-u (bashkëpunimi civilo-ushtarak) i KFOR-it. Në kuadër të këtij projekti shkollës iu dhuruan projektorë dhe llaptopë për kabinetin e lëndës së TIK-ut. Sigurisht, investimet e tilla janë të mirëseardhura pasi që ato ndikojnë drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe mësim nxënies.



# EJHS " GJ. K. SKENDERBEU" SALLAGRAZHDE

*The green environment, cleanliness and order are the first three things that you see as soon as you enter the courtyard of the Elementary and Junior High School (SHFMU) "Gj. K. Skënderbeu" in the village of Sallagrazhdë. The fact that the school is located in a village that lies at the foot of the mountains of Sharr only adds to the charm of this facility of knowledge. Good impressions continue inside the school too. The director of this school Mr. Bafti Gashi, says that everything in this school has been achieved in the first place thanks to the unsparing work and commitment of the entire school team, of course, without forgetting the parents and especially the students themselves.*




### Rënia e numrit të nxënësve problem, por puna nuk ndalet

Për fat të keq, si shumë shkolla të tjera në Kosovë, edhe kjo shkollë është duke u përballur me rënien e numrit të nxënësve. Z. Gashi, theksoi se ky është një problem shumë serioz me të cilin përballet jo vetëm shkolla por i tërë fshati, pasi që një pjesë e konsiderueshme e banorëve të këtij fshati kanë imigruar në botën e jashtme. Rënia e numri të nxënësve mund të jetë problem serioz, por jo edhe angazhimi i nxënësve. Këtë e dëshmon fakti se pjesa dërmuese e nxënësve të kësaj shkolle i vijojnë apo i kanë përfunduar studimet e tyre në fusha të tilla si mjekësi, ekonomi, ndërtimtari, bujqësi e fusha të tjera të rëndësishme për tregun e punës në Kosovë. Kur merret parasysh se këta fëmijë vijnë nga Sallagrazhda me rreth 300 shtëpi dhe Dubrava me rreth 160 shtëpi, atëherë është e qartë se sa shumë çmohet shkollimi dhe dija në këto anë.



### Investoni në dijen tuaj

***Në fund z. Gashi i porositi të gjithë të rinjtë e Kosovës se është tejet e rëndësishme që sapo të zgjohen në mëngjes, ata duhet ta kenë të qartë qëllimin pse përgatiten për të ardhur në shkollë dhe ta shfrytëzojnë këtë kohë me gjithë këto mundësi të mira për të mësuar; sepse perspektiva është në anën e atyre që mësojnë dhe investimi më i mirë për të ardhmen e tyre, është investimi në dijen e tyre.***

### All the positive initiatives have come from the students

According to the director of the school, the main reason for their success is the cooperation that the staff, both administrative or teaching, have created with the students throughout the years of its operation. As a result of this cooperation, school bodies such as the students' or parents' councils are very active. "Cooperation is at such a good level that I would say that all the positive initiatives have come from the students, but more importantly they were, at least partially, implemented by the students themselves. On the other hand, the fact that the ideas came and were implemented by the children themselves, has influenced them to become the main guardians of the school environment," director Gashi stated. He emphasized that the spirit of cooperation in this school is of very special importance. "About thirty percent of the inhabitants of Sallgrazhdë belong to the Catholic religion. This means that in this school students of different religious beliefs follow the lectures. Despite this, we have never had problems due to these differences be it at the school or in our village."

### Thanks to investments over the years the school is in a good condition

Regarding the condition of the school building, director Gashi said that thanks to the various projects that have been carried out so far, the school building is in a very good shape and meets the requirements for the education process. For example, a few years ago, thanks to a project carried out by the European Commission, about 300,000 euros were invested in this school at that time, for the insulation and painting of the entire school, the adjustment of the roof and the installation of the central heating system. Another valuable investment, about which we have already written in our magazine, was completed only a few months ago by CIMIC (civil-military cooperation) of KFOR. Within this project, projectors and laptops were donated to the school for the ICT subject cabinet. Of course, such investments are welcome as they directly affect the quality of the teaching and learning process.

### Students' number decrease is a problem, but the work goes on

Unfortunately, like many other schools in Kosovo, this school is facing a decline in the number of students. Mr. Gashi emphasized that this is a very serious problem faced not only by the school but by the whole village, since a significant part of the inhabitants of this village have immigrated out of the country. The decrease in the number of students might be a serious problem, but not the engagement of students. This is proven by the fact that a large part of the students of this school continue or have completed their studies in fields such as medicine, economics, construction, agriculture and other important fields for the labor market in Kosovo. When you consider that these children come from Sallagrazhdë with about 300 houses and Dubrava with about 160 houses, then it is clear how much education and knowledge are valued in these parts.

### Invest in your knowledge

***In the end Mr. Gashi instructed all the young people of Kosovo that it is very important that as soon as they wake up in the morning, they should have a clear goal why they are preparing to come to school and use this time with all these good opportunities to learn; because the perspective is on the side of those who learn and the best investment for their future is investing in their knowledge.***

# DEZINFORMATAT:
## *RËNDËSIA E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT*

# VERIFIKO!

**V** **Verifikoje burimin e informacionit tënd!**

**E** **Eliminoje çdo burim të dyshimtë të informacionit!**

**R** **Ruaju nga informacionet e rreme!**

**I** **Interesohu për vërtetësinë e lajmit!**

**F** **Fakte! Fakte! Fakte!**

**I** **Identifikoje autorin!**

**K** **Krahasoji informacionet dhe burimet e tyre me njëra-tjetrën!**

**O** **Orientoji miqtë/shokët e tu te burimet e sakta!**

**ZBULONI DHE SHPËRFILLNI DEZINFORMATAT!**

***Në epokën digjitale, interneti është bërë burimi kryesor i informacionit për shumë njerëz. Megjithatë, me rritjen e disponueshmërisë së informacionit, është rritur gjithashtu edhe shpërndarja e dezinformatave. Sipas Fjalorit të Oksfordit të Gjuhës Angleze dezinformimi përkufizohet si në vijim: Një formë e propagandës e cila e përfshinë shpërndarjen e informacionit të rrejshëm me qëllim të mashtrimit.***

***VERIFIKO çdo informatë***

Për të qenë të mirë informuar por, edhe për të pasur një qasje të ndërgjegjshme ndaj informacionit dhe për të mos i dhënë jehonë informacioneve të pasakta që mund të përhapin panik apo edhe shkaktojnë dëme shumë të mëdha, është e nevojshme që të gjithë ne të praktikojmë verifikimin e informacionit. Prandaj, kur bëhet fjalë për informacionet që i lexoni apo shihni në internet gjithmonë kujtojeni fjalën: ***VERIFIKO!***

***Hapat për verifikimin e informacionit:***

***V - Verifikoni burimin:*** Para se ta pranoni dhe ta ndani me të tjerët një informacion apo lajm, kontrolloni burimin e tij. Sigurohuni që burimi është i besueshëm dhe i mbështetur nga burime të tjera të besueshme.

***E - Eliminoni burimet e dyshimta:*** Nëse e hasni një burim të dyshimtë, që sjell informacion të pavërtetë, të gabuar ose të rremë, eliminojeni atë. Mos e ndani dhe mos përhapni informacion që nuk konfirmohet edhe nga burime të tjera të besueshme.

***R - Ruajuni nga informacionet e rreme:*** Informacionet e rreme mund të sjellin pasoja të dëmshme. Mos u bëni pjesë e propagandës, teorive konspirative apo lajmeve të pavërteta. Tregohuni vigjilent dhe mos e pranoni si të qenë asnjë lajm apo informacion të cilin nuk mund ta verifikoni apo mbështesni me fakte dhe burime të tjera.

***I - Interesohuni për vërtetësinë e lajmit:*** Para se t'i besoni një lajmi, bëjeni një kërkim të vogël vetë. Kontrolloni nëse ka raporte të tjera të besueshme që e konfirmojnë apo edhe e mohojnë atë. Mos u besoni menjëherë lajmeve bombastike dhe emocionale të cilat nuk ofrojnë fakte të vërteta.

***F- Fakte! Fakte! Fakte!:*** Një nga mënyrat më të mira dhe më të sigurta për t'i zbuluar dezinformatat apo lajmet e rreme është që t'i kërkoni dhe kontrolloni faktet. Kërkoni informacione të verifikuara dhe të konfirmuara nga burime të besueshme. Mos i pranoni thashethemet, spekulimet apo pretendimet pa bazë solide.

***I - Identifikoni autorin:*** Shikoni kush është autori i informacionit dhe çfarë kredencialesh apo përvoje ka ai. Për të identifikuar autorin, fillimisht shikoni nëse artikulli ose informacioni e ka një firmë të qartë. Autorët e informacionit të besueshëm zakonisht do të identifikohen me emër dhe, nëse është e mundur, me informacione shtesë për t'i njohur më mirë ata. Kjo mund të përfshijë lidhjet e tyre me institucione, organizata, apo studime të realizuara në fushën e caktuar.

***K - Krahasoni informacionet dhe burimet:*** Një nga hapat më të rëndësishëm për të verifikuar një informacion është krahasimi i tij me burime të tjera të besueshme. Kontrolloni nëse të dhënat dhe faktet janë të përputhshme nëpërmjet burimeve të ndryshme. Nëse e gjeni ndonjë mos konsistencë ose kontradiktë, tregohuni të vëmendshëm dhe mos e pranoni informacionin si të vërtetë pa bërë më shumë hulumtim.

***O - Orientoni miqtë/shokët tuaj te burimet e sakta:*** Pjesa më e rëndësishme në luftën kundër përhapjes së dezinformatave është ndikimi pozitiv që mund të keni tek të tjerët. Ndani me miqtë dhe shokët tuaj praktikat e verifikimit të informacionit dhe tregojuni atyre se si mund të mbrohen nga dezinformimi. Ndihmoni ata që të identifikojnë burimet e sakta dhe si të vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin që ndajnë me të tjerët.

### Luftoni dezinformatat

*Të jetosh në një shoqëri me informacion të vërtetë dhe të saktë është e drejtë e çdo individi. Ndaj, bëhuni pjesë e luftës kundër përhapjes së dezinformatave dhe praktikoni verifikimin e informacionit në çdo moment. Duke e bërë këtë ju siguroheni që të mos përfshiheni në vorbullën e propagandave qofshin ato të qëllimshme apo pa dashje. Kështu mund të ndikoni në krijimin e një mjedisi të ndërgjegjshëm dhe të sigurt për të gjithë. Po ashtu, duke u angazhuar në këto praktika të verifikimit të informacionit, ju ndihmoni në promovimin e një mjedisi të përgjegjshëm dhe të saktë të informacionit në internet.*

*ZBULONI DHE SHPËRFILLNI DEZINFORMATAT!*

Na vizitoni në:
Visit us at:

# DISINFORMATION: *THE IMPORTANCE OF VERIFYING THE INFORMATION*

***In the digital era, the Internet has become the main source of information for many people. However, as the information availability has increased so has the spread of disinformation. The Oxford English Dictionary defines disinformation as follows: A form of propaganda involving the dissemination of false information with the deliberate intent to deceive or mislead.***

***VERIFY all Information!***
In order to be well informed but to also have a responsible approach to information and to not trumpet inaccurate information that may spread panic or even cause serious damage, it is necessary that we all practice information verification. Therefore, in relation to the information you read or watch on the Internet always remember the word: ***VERIFIKO (VERIFY)!***

***Information verification steps:***

***V - Verify the source:*** Before you accept and share with others a piece of information or a news, check its source. Make sure the source is credible and supported by other credible sources.

***E - Eliminate suspicious sources:*** If you encounter a suspicious source, that brings untruthful, inaccurate, or fake information, eliminate it. Do not share and do not spread any information that is not confirmed by other credible sources as well.

***R - Beware of fake information:*** Fake information may cause harmful outcomes. Do not become a part of the propaganda, conspirative theories, or fake news. Be vigilant and do not accept as true any information that you cannot verify or support with other facts or sources.

***I - Check the news accuracy:*** Before trusting a news story, do a little research. Check if there are other credible reports that confirm or even deny it. Do not trust immediately any bombastic and emotional news that do not provide true facts.

***F - Facts! Facts! Facts!:*** One of the best and surest ways to discover disinformation or fake news is to seek and check the facts. Seek verified information from credible sources. Do not accept gossip, speculation or claims without solid based facts.

***I - Identify the author:*** Check the author and what her/his credentials and experience are. To identify the author check if the article or information has a clear signature. Authors of credible information usually will be identified by their full name and when possible, with additional information that helps to know them better. This may include additional information to better introduce them. This may also include their links to institutions, organizations and studies conducted in the specific field.

***K - Compare information and sources:*** one of the most important steps in information verification is to compare it with other credible sources. Check if the data and facts are compatible with other sources. If you find any inconsistencies or contradictions beware and do not accept the said information as true without doing any further research.

***O - Direct your friends to accurate sources:*** The most important part in the fight against disinformation is the positive impact you can have on others. Share with your friends the information verification practices and tell them how they can protect themselves from disinformation. Help them identify accurate sources and how to critically evaluate the information they share with each other.

### Fight disinformation

*Living in a society with truthful and accurate information is the right of each individual. Therefore, join in the fight against the spread of disinformation and practice information verification at all times. By doing so you ensure to avoid becoming part of the propaganda windmill be it if they are intended or unintended. This way you will help create a safe and responsible environment for all. Moreover, by engaging in such information verification practices, you will help promote a responsible and accurate information environment on the Internet.*

*DETECT AND DISREGARD DISINFORMATION!*



# TEUTË HALILI

## *KËNGËTARJA E RE SYPATREMBUR NË SKENËN TONË MUZIKORE!*

**Çka e veçon Teutë Halilin si këngëtare në skenën e muzikës shqipe?**
Nuk jam personalitet që i ndjek trendët!

**Çfarë ju ka frymëzuar dhe shtyrë për të nisur këtë rrugëtim në muzikë?**
Muzika është e vetmja sferë, ku hapësira e të shprehurit nuk kufizohet!

**Kënga "Dhimbje" ishte kënga e parë me të cilën u prezantove para publikut dhe tanimë e ke realizuar edhe këngën "TML". Sa e kanë prezantuar këto dy këngë atë që publiku mund ta pres nga ju?**
Nuk ka qenë asnjëherë ideja që të krijoj pritshmëri te publiku, ideja ka qenë që të prodhoj çka ndjej, duke uruar që do të mirëpritet tek publiku.

**Sa ju pengon apo ndihmon fakti se para muzikës keni qenë prezantuese e lajmeve?**
Më duhet ta pranoj se ka qenë një sfidë, sepse ekziston një tendencë e profilizimit te publiku, por thellë besoj që publiku e ka mirëpritur edhe muzikën time.

**Teutë Halili mund të përkufizohet si një forcë sypatrembur në skenën e muzikës shqiptare. E pakufizuar nga trendet, ajo pa pikë frike dhe hezitimi i është futur hapësirës së shprehjes së pakufizuar që e ofron muzika. Me këngën e saj debutuese "Dhimbje" si dhe publikimin e saj më të ri "TML", Teuta e ka bërë për vete publikun me krijimet e saj autentike dhe origjinale. E njohur deri tani si prezantuese e lajmeve, ajo i tejkalon pritjet dhe e dëshmon që pasioni i saj për muzikën nuk njeh kufij. Në vijim ju ftojmë që të futeni në botën e kësaj artisteje të mrekullueshme, për t'i zbuluar frymëzimet, sfidat dhe bukurinë e pafund që ajo synon ta sjell në muzikën shqipe.**



# TEUTË HALILI

## *THE NEW FEARLESS SINGER IN OUR MUSIC SCENE!*

**Teutë Halili can be defined as a fearless force in the Albanian music scene. Unbound by trends, she fearlessly and without hesitation entered the space of unlimited expression that music offers. With her debut song "Dhimbje" and her latest release "TML", Teuta has won over the audience with her authentic and original creations. Known until now as a news presenter, she exceeds expectations and proves that her passion for music knows no boundaries. Below we invite you to enter the world of this wonderful artist, to discover her inspirations, challenges and endless beauty that she aims to bring to the Albanian music.**

**What distinguishes Teutë Halili as a singer in the Albanian music scene?**
I am not a personality that follows trends!

**What inspired and motivated you to start this journey in music?**
Music is the only sphere where the space of expression is not limited!

**The song "Dhimbje" was your first song that introduced yourself to the public and now you have also released the song "TML". How much have these two songs presented what the public can expect from you?**
It was never the idea to create expectations in the public, the idea was to produce what I feel, hoping that it will be welcomed by the public.

**How much does it hinder or help you that before music you were a news presenter?**
I have to admit that it was a challenge, because there is a tendency of profiling in the public, but I deeply believe that the public has welcomed my music as well.

**You are taking your first steps in the music scene, so far what is the biggest challenge for you as an artist?**
I understand that financial benefits are part of this industry, but the idea was to achieve benefits by producing what we feel.

**Has your break into the music scene brought you what you expected?**
So far I am more than satisfied with the production of songs.

**Every singer or singer at the beginning of their career must produce songs and projects that suit more market and public demands than personal tastes or preferences. How much are your projects so far in line with genre where you feel most comfortable?**
My songs so far have not been created in accordance with market and I continue to believe that public will always welcome the "original phenomenon".

**Where do you feel most comfortable?**
I feel comfortable wherever I do not feel a frame of expression.

**What is your creative process for making a song or musical project?**
Inspiration comes from phases which I go through in life, perspective on life from the position I am in, inspires me to be able to summarize emotions in melody.

**Can you talk about any upcoming project or collaboration that you are preparing?**
I am creating only from desire, I cannot promise anything more.

**Jeni duke i hedhë hapat e parë në skenën e muzikës, deri tani cila është sfida më e madhe për ju si artiste?**
E kuptoj që përfitimet financiare janë pjesë e kësaj industrie, mirëpo ideja ka qenë që të arrijmë tek përfitimet duke prodhuar atë çka e ndjejmë.

**A të ka sjellë depërtimi në skenën muzikore atë që e ke pritur?**
Deri tani jam më se e kënaqur me prodhimin e këngëve.



**Çdo këngëtare apo këngëtar në fillim të karrierës duhet të realizojë këngë dhe projekte që i përshtaten më shumë tregut dhe kërkesave të publikut se sa shijeve apo preferencave personale. Sa janë projektet e tua të deritanishme në përputhje me atë zhanrin ku ti e ndien veten më rehat?**
Këngët e mia deri tani nuk janë krijuar në përshtatje me tregun dhe unë vazhdoj të besoj që publiku gjithmonë do ta mirëpret "fenomenin origjinal".

**Ku e ndjen veten më rehat?**
Veten e ndjej rehat kudo ku nuk ndjej kornizë të të shprehurit.

**Si është procesi i juaj krijues për realizimin një kënge apo projekti muzikor?**
Inspirimi vjen nga fazat të cilat i kaloj në jetë, perspektiva ndaj jetës prej pozicionit ku ndodhem, më inspiron që të arrij ta përmbledh emocionin në melodi.

**A mund të flisni për ndonjë projekt apo bashkëpunim të ardhshëm që jeni duke e përgatitur?**
Jam duke krijuar vetëm nga dëshira, nuk mund të premtoj asgjë më shumë.

**Si e baraspeshoni jetën tuaj personale me kërkesat për të qenë muzikante dhe personazh publik?**
Modestia, është çelësi i baraspeshës në "jetën e personazhit publik".

**Muzika apo gazetaria?**
Janë dy sfera që më plotësojnë në dy mënyra të ndryshme. Përderisa vazhdon dashuria për të dyja, vazhdojmë edhe me punë.



**Si i qaseni ndërtimit dhe mbajtjes së marrëdhënieve me fansat?**
Po e cek edhe njëherë, modestia është pika ku fillon krijimi i marrëdhënieve me publikun.

**A mund të flisni për ndonjë hobi apo interes që e keni jashtë muzikës?**
Gatimi! Kuzhina është pjesë e pandashme e imja, është formë e meditimit.



**Cila është këshilla më e mirë që ua kanë dhënë ndonjëherë?**
Këshilla më e mirë ndonjëherë për mua vjen nga prindërit e mi: "Jeta është cikël, dhe në një pikë të caktuar, do të jemi 'ushqim' i dikujt tjetër - So be nice to everyone! (Kështu që sillu mirë me të gjithë!)".

**Tri momentet kyçe në jetën tuaj?**
Pavarësia nga familja, kyçja në gazetari, dhe investimi në kohën personale.

**Cila është humbja më e madhe në jetë?**
"Është Yin dhe Yang" - jeta është mrekulli që vjen me baraspeshën e saj. Asgjë e keqe nuk vjen pa diçka të mirë, dhe anasjelltas. Për këtë arsye, e kam "mësuar" veten që të mos shoh asgjë si humbje në jetë.

**Cila është fitorja më e madhe në jetë?**
Fitorja më e madhe në jetë është mposhtja e egos, momenti definitiv jetësor, kur si individ e kupton që ti je gjithçka dhe asgjë në të njëjtën kohë!

**Facebook, Instagram, Snapchat, WhatsApp, TikTok apo...?**
Momentalisht Instagram dhe Facebook, për shkak të punës; më duhet ta cek që nuk jam adhuruese e madhe e teknologjisë.

**Telefonatat, posta elektronike (email), apo porositë (SMS)?**
Definitivisht, telefonatat - biseda me shumë shqisa gëzon më pak tendencë për keqkuptime.

**A përdorni simbole (emoji) në komunikimin tuaj dhe cilat i përdorni më shpesh?**
I përdori nëse duhet, në mënyrë që mesazhi të përcillet i qartë te personi i caktuar.

**A mund ta shkruani një porosi vetëm me simbole dhe të na e shpjegoni?**
✌🏻 = paqe. Paqja e sjell formën më të përsosur të dashurisë, fuqisë më të madhe ekzistuese.

**Porosia më e çuditshme, më qesharake dhe më e pavend që e keni pranuar nga ndokush?**
"S'po din me nejtë VIP!" – Kjo është fjalia më qesharake dhe më e çuditshme që e kam dëgjuar ndonjëherë.






### Cilat janë pikat e tua më të dobëta që t'i synon që t'i përmirësosh?
Durimi, është pika ime e dobët. Jam person që e bëj punën 100%, dhe pres rezultate të shpejta!

### Për çfarë ke dëshirë të mbahesh në mend më së shumti?
"For being real" (Se kam qenë vetvetja). Fuqia e një njeriu nuk fillon në potencialin e tij për të ndikuar te masa, por tek ndikimi te individët. Nëse ka raste që unë ia kam arrit që ta ndryshoj jetën e një individi, "It makes me feel good!" (kjo më bën të ndjehem mirë!).

### Radhiti sipas rëndësisë: Puna, Talenti dhe Pasioni?
Pasioni, puna, talenti - talenti nuk triumfon pa pasion, e pasioni pa punë nuk jetësohet!

### Cila është porosia e juaj për lexuesit tanë?
Porosia ime është: "Its a tough world out there, but that's what makes it beautiful, always remember, love yourself so u can be loved from everybody else ♥" (Bota është e egër, por kjo është çka ia jep asaj bukurinë, mbani mend gjithmonë, dojeni veten në mënyrë që të mund t'ju duan të gjithë të tjerët ♥).

### How do you balance your personal life with the demands of being a musician and public figure?
Modesty is key to balance in "the life of a public figure".

### Music or journalism?
They are two spheres that fulfill me in two different ways. As long as love for both continues, we continue with work.

### How do you approach building and maintaining relationships with fans?
I emphasize it again, modesty is the point where the creation of relationships with the audience begins.

### Can you talk about any hobby or interest that you have outside of music?
Cooking! Kitchen is an inseparable part of mine, it is form of meditation.

### What is the best advice that anyone ever gave you?
Best advice ever for me comes from my parents: "Life is cycle, and at some point, we will be 'food' for someone else - So be nice to everyone!"

### Three key moments in your life?
Independence from family, entry into journalism, and investment in personal time.

### What is the biggest loss in life?
"It's Yin and Yang" - life is a miracle that comes with its balance. Nothing bad comes without something good, and vice versa. For this reason, I have "taught" myself not to see anything as a loss in life.

### What is the biggest victory in life?
The biggest victory in life is overcoming the ego, the definitive moment of life, when as an individual you realize that you are everything and nothing at the same time!

### Facebook, Instagram, Snapchat, WhatsApp, TikTok or...?
Currently Instagram and Facebook, because of work; I have to say that I am not a big fan of technology.

### Phone calls, email, or text messages?
Definitely phone calls - conversation with more senses has less tendency for misunderstanding.

### Do you use emojis in your communication and which ones do you use most often?
I use them if necessary, in order to convey the message clearly to the person concerned.

### Can you write a message only with emojis and explain it to us?
✌ = peace. Peace brings the most perfect form of love, the greatest existing force.

### The most surprising, funny and inappropriate message that you have received from someone?
"You don't know how to be VIP!" - This is the funniest and most surprising sentence I have ever heard.

### What are your weakest points that you aim to improve?
Patience is my weak point. I am a person who does 100% of the work, and I expect quick results!

### What do you want to be remembered for most?
"For being real" (Being myself). The power of a human being does not start in his potential to influence the masses, but in his influence on individuals. If there are cases where I have managed to change the life of an individual, "It makes me feel good!"

### Rank by importance: Work, Talent and Passion?
Passion, work, talent - talent does not triumph without passion, and passion without work does not come alive!

### What is your message for our readers?
My message is: "It's a tough world out there, but that's what makes it beautiful, always remember, love yourself so u can be loved from everybody else ♥"

# DEFY THEM:

# BASHKIMI I KOMUNITETIT PËRMES MUZIKËS DHE ARTIT




***Në një shoqëri ku komunikimi ndëretnik mund të jetë sfidues, një organizatë joqeveritare e quajtur 'Defy Them' po bën bujë në skenën e arteve alternative dhe muzikës. Me një qasje të shumëanshme, Defy Them' synon të mbështesë dhe fuqizojë artistët duke i nxitur lidhjet ndërmjet komuniteteve. Përmes iniciativave të ndryshme, kjo organizatë po i thyen barrierat dhe po e promovon gjithpërfshirjen në një shoqëri shpesh të ndarë në bazë të vijave etnike dhe sociale.***

## Një qendër kreativiteti dhe bashkëpunimi

Në zemër të 'Defy Them' është 'Defy Them Records', një studio regjistrimi ku artistë aspirantë me prejardhje të ndryshme dhe grupe në zhvillim mund të sjellin muzikën e tyre në jetë. Organizata gjithashtu e drejton një shkollë muzikore që ofron kurse në kitarë, bateri, perkusion, bas dhe vokal. Kohët e fundit, ata kanë prezantuar një kurs të inxhinierisë dhe prodhimit të tingullit për të zgjeruar më tej ofertat e tyre. Për më tepër, Defy Them' pret një qendër kulturore që fokusohet në projekte që i adresojnë të gjitha komunitetet etnike që jetojnë në Kosovë, inteligjencën artificiale, artin, gazetarinë dhe median. Lira Blakaj, Drejtoresha Ekzekutive e 'Defy Them, e theksoi rëndësinë e angazhimit të të rinjve në aktivitete jashtëshkollore. Ajo i inkurajoi të rinjtë që të eksplorojnë ndjekje të ndryshme artistike, të zgjerojnë horizontet e tyre dhe të kapërcejnë kufijtë etnikë, gjinorë dhe racor. Blakaj theksoi se përmes aktiviteteve të duhura, njerëzit mund të kuptojnë më mirë njëri-tjetrin dhe kolektivisht t'i tejkalojnë sfidat sociale, duke e nxitur një Kosovë më të suksesshme dhe më të bashkuar.

## Festimi i diversitetit përmes muzikës

Një nga ngjarjet e fundit të Defy Them, i mbështetur nga USAID dhe i menaxhuar nga YIHR Kosovë, kishte për qëllim që të bashkonte muzikantë, kore dhe artistë nga komunitete të ndryshme që banonjnë në Kosovë. Në prani të mbi njëqind të rinjve të etnive të ndryshme, programi i ditës filloi me recitimin e një poezie të shkruar nga një vajzë serbe, e përkthyer në gjuhën rome dhe shqipe. Poema e theksoi rëndësinë e pajtimit dhe paqes ndërmjet komuniteteve. Pasuan performancat muzikore, duke filluar me qendrën muzikore 'Music for All' që shfaqi korin dhe instrumentistët e tyre nga Plemetina. Një performancë me daulle e udhëhequr nga studentët e talentuar të instruktorit Tauman Ukça i shtoi ritmin e ngjarjes. Më në fund, skena mirëpriti 'Nuclear Doom', një grup muzikantësh të rinj 13-14 vjeç nga 'Defy Them', duke e mbyllur koncertin me një notë energjike.

Xhemajl Mustafa, mentor në 'Music For All', shprehu kënaqësinë e tij që fëmijët të përfshihen në këtë ngjarje. Ai vuri në dukje se muzika ka fuqinë t'i bashkojë njerëzit, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, dhe theksoi përparimin që po bëhet në bashkimin e shoqërisë së Kosovës. Ndjenja e tij u mbështet më tej nga Dimitrije Obrenovic, një bashkëpunëtor paqeje dhe asistent projekti në YIHR. Ky i fundit theksoi rëndësinë e ngjarjeve si këto në promovimin e komunikimit dhe mirëkuptimit ndëretnik. Ai shprehu mirënjohjen për donatorët dhe



taksapaguesit nga BE-ja dhe SHBA-ja që mbështesin nisma të tilla, duke mundësuar ndryshime pozitive në jetën e të rinjve. Nga ana tjetër, kolegia e tij nga YIHR Hana Berisha, dhe një nga organizatoret kryesore të ngjarjes së mësipërme, theksoi rëndësinë e gjithëpërfshirjes dhe nevojën për të shpërndarë narrativën e përjashtimit duke përfshirë të gjitha komunitetet në aktivitete të përbashkëta të ngjashme.

### Një hap drejt nismave më të mëdha

Përderisa kjo ngjarje shërbeu si një aktivitet ad hoc, znj. Blakaj na tha se Defy Them' është në proces të zhvillimit të një programi gjithëpërfshirës që synon angazhimin e komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Ky program afatgjatë do të përfshijë punëtori, kurse instrumentesh, kompozim muzikor dhe formimin e grupeve ndëretnike. Duke ushqyer talentet artistike dhe duke promovuar bashkëpunimin, Defy Them' përpiqet të krijojë një shoqëri më harmonike dhe të lehtësojë rritjen e Kosovës.

### Një mesazh për të rinjtë: ëndrrat, unitet dhe përparim

Së bashku, organizatorët dhe mentorët përcollën një mesazh tingëllues për të rinjtë e Kosovës. Ata i inkurajuan që të ndjekin ëndrrat e tyre, të qëndrojnë kureshtarë dhe të punojnë drejt një të ardhmeje të përbashkët. Ata theksuan fuqinë transformuese të artit dhe muzikës si një mjet për të arritur ndryshimin dhe kohezionin shoqëror. Duke u angazhuar në përpjekje krijuese, të rinjtë kanë mundësinë të sfidojnë stereotipet, të ndërtojnë ura dhe të nxisin ndjeshmërinë dhe mirëkuptimin midis komuniteteve të ndryshme.

*DEFY THEM - është një organizatë joqeveritare që mbështet skenën e artit dhe muzikës alternative në Kosovë. Përbëhet nga disa shtylla, duke përfshirë:*

- *Defy Them Records - një studio regjistrimi ku muzikantët dhe grupet e reja mund të regjistrojnë këngët e tyre,*
- *Shkolla e Muzikës Defy Them – e cila zhvillon kurse për instrumente të ndryshme dhe trajnim vokal, dhe*
- *Qendra e Kulturës Alternative - e cila është e përkushtuar për fuqizimin e artistëve dhe krijimin e projekteve nga të cilat përfitojnë të gjitha komunitetet etnike në Kosovë.*

*Qëllimi i tyre kryesor është të kapërcejnë barrierat dhe të nxisin paqen, lumturinë dhe bashkëpunimin*

Na vizitoni në:
Visit us at:

# DEFY THEM:
# UNITING COMMUNITIES THROUGH MUSIC AND ART

***In a society where interethnic communication can be challenging, a non-governmental organization named 'Defy Them' is making waves in the alternative arts and music scene. With a multi-faceted approach, 'Defy Them' aims to support and empower artists while fostering intercommunity connections. Through their diverse initiatives, this organization is breaking down barriers and promoting inclusivity in a society often divided by ethnic and social lines.***

### A Hub of Creativity and Collaboration

At the heart of 'Defy Them' is 'Defy Them Records', a recording studio where aspiring artists from different backgrounds and emerging bands can bring their music to life. The organization also operates a music school that offers courses in guitar, drums, percussion, bass, and vocals. Recently, they have introduced a sound engineering and production course to further expand their offerings. Additionally, 'Defy Them' hosts a cultural center that focuses on projects addressing all ethnic communities living in Kosovo, artificial intelligence, art, journalism, and media. Lira Blakaj, the Executive Director of 'Defy Them', highlighted the importance of engaging youth in extracurricular activities. She encouraged young people to explore different artistic pursuits, broaden their horizons, and transcend ethnic, gender, and racial boundaries. Blakaj emphasized that through appropriate activities, people can better understand each other and collectively overcome social challenges, fostering a more successful and united Kosovo.

### Celebrating Diversity through Music

One of Defy Them's recent events, supported by USAID and managed by YIHR Kosovo, aimed to bring together musicians, choirs, and artists from various communities residing in Kosovo. In the presence of over a hundred youngsters of different ethnicities, the day's program commenced with the recitation of a poem written by a Serbian girl, translated into Romani and Albanian. The poem emphasized the importance of reconciliation and peace among communities. Music performances followed, starting with 'Music For All' music center that showcased their choir and instrumentalists from Plemetina. A drum performance led by instructor Tauman Ukça's talented students added rhythmic flair to the event. Finally, the stage welcomed 'Nuclear Doom', a group of young musicians aged 13-14 from 'Defy Them', closing the concert on an energetic note.

Xhemajl Mustafa, a mentor at 'Music For All', expressed his delight in having children involved in the event. He noted that music has the power to bring people together, regardless of their ethnicity, and emphasized the progress being made in unifying Kosovo's society. His sentiment was further supported by Dimitrije Obrenovic, a peace fellow and project assistant at YIHR. The latter emphasized the significance of events like these in promoting interethnic communication and understanding. He expressed gratitude to donors and taxpayers from the EU and US who support such initiatives, enabling positive changes in the lives of young people. On the other hand, his colleague from YIHR Hana Berisha, and one of the main organizers of the foregoing event, emphasized the importance of inclusivity and the need to dispel the narrative of exclusion by involving all communities in similar joint activities.

### A Steppingstone Towards Greater Initiatives

While this event served as an ad hoc activity, Ms. Blakaj told us that 'Defy Them' is in the process of developing a comprehensive program that aims to engage non-majority communities in Kosovo. This long-term program will include workshops, instrument classes, music composition, and the formation of interethnic bands. By nurturing artistic talents and promoting collaboration, 'Defy Them' strives to create a more harmonious society and facilitate the growth of Kosovo.

### A Message to the Youth: Dreams, Unity, and Progress

Collectively, the organizers and mentors conveyed a resounding message to the youth of Kosovo. They encouraged them to pursue their dreams, stay curious, and work towards a common future. They highlighted the transformative power of art and music as a means to achieve social change and cohesion. By engaging in creative endeavors, young people have the opportunity to challenge stereotypes, build bridges and foster empathy and understanding among different communities.

*DEFY THEM - is a non-governmental organization that supports the alternative arts and music scene in Kosovo. Comprised of several pillars, including:*

- *Defy Them Records - a recording studio where young musicians and bands can record their songs,*
- *Defy Them Music School - which conducts courses in various instruments and vocal training, and*
- *The Alternative Culture Center - which is dedicated to empowering artists and creating projects that benefit all ethnic communities in Kosovo.*

*Their main goal is to transcend barriers and foster peace, happiness, and cooperation through music and art.*

# TË NJIHEMI ME PESË UNIVERSITETET KULMORE NË BOTË

*Pavarësisht nëse jeni student që mendoni për arsimimin tuaj të ardhshëm ose thjesht dëshironi të zgjeroni njohuritë tuaja për universitetet më të mira në botë, ky udhëtim nëpër elitën akademike do t'ju japë një pasqyrë të përsosmërisë dhe diversitetit të arsimit në nivel global.*











Në shoqërinë e sotme, arsimi luan një rol kyç në formësimin dhe zhvillimin e shoqërive progresive. Universitetet janë bërë vatra të përparimit intelektual, inovacionit dhe kërkimit që i formësojnë brezat e ardhshëm të liderëve, shkencëtarëve dhe sipërmarrësve. Midis shumë institucioneve arsimore në mbarë botën, universitetet e caktuara spikaten si qendra kulmore të ekselencës akademike. Secili prej këtyre universiteteve mbart historinë e vet unike, traditën akademike dhe ndikimin kulturor që i bën ata të veçantë në pejsazhin arsimor global. Nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës der në Mbretërinë e Bashkuar, këto universitete joshin studentë nga e gjithë bota dhe krijojnë një atmosferë të diversitetit intelektual.

Secila prej tyre sjell jo vetëm një reputacion të jashtëzakonshëm akademik, por edhe një histori të pasur të arritjeve, të cilat kanë formësuar botën në shumë mënyra. Rangimi i universiteteve mund të ndryshojë varësisht nga burimi dhe metoda e përdorur nga një burim i caktuar, megjithatë këto pesë universitete mbajnë një rangim vazhdimisht të lartë në shumë lista ndërkombëtare. Ato spikaten për historinë e tyre të pasur, reputacionin e mirë dhe ndikimin në botën akademike, por janë edhe qendra të inovacionit dhe arritjeve të shumta në fusha të ndryshme. ATO JANË:

## Universiteti i Harvardit

Harvard u themelua në vitin 1636 dhe është një nga universitetet më të vjetra në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Harvardi është shtëpia e bibliotekës më të madhe universitare në Amerikën e Veriut, Biblioteka e Harvardit, e cila i ka mbi 20 milionë libra. Shumë politikanë, shkencëtarë, shkrimtarë dhe drejtues biznesi të famshëm kanë studiuar në Harvard, duke i përfshirë ish-presidentët e SHBA-së Barack Obama, John F. Kennedy dhe George W. Bush.

## Universiteti i Stanfordit

Stanford ndodhet në Silicon Valley të Kalifornisë, i njohur për zhvillimin teknologjik. Universiteti u themelua në vitin 1885 dhe është një nga universitetet më prestigjioze në SHBA. Stanford është shtëpia e Spitalit Stanford, një nga institucionet mjekësore më të vlerësuara në SHBA. Stanford është i njohur për fokusin e tij në sipërmarrjen dhe zhvillimin teknologjik. Shumë kompani teknologjike, si Google, Yahoo dhe Hewlett-Packard, u themeluan nga ish-studentët e Stanfordit.

## Universiteti i Kembrixhit

Kembrixhi është një nga universitetet më të vjetra në botën anglishtfolëse, i themeluar në vitin 1209. Shkencëtarë të famshëm si Isaac Newton, Charles Darwin dhe Stephen Hawking studiuan në këtë universitet. Universiteti i Kembrixhit përbëhet nga 31 kolegje, secili me traditën dhe arkitekturën e veçantë.

## Universiteti MIT

MIT u themelua më 1861 dhe është i fokusuar në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë. MIT është shtëpia e Kupolës së famshme, e cila është bërë simboli i universitetit. MIT e ka një reputacion për inovacion dhe kërkime. Të diplomuarit e saj kanë themeluar shumë 'startup' dhe kompani të teknologjisë.



## Universiteti i Oksfordit

**Oksford është një nga universitetet më të vjetra në botë, i themeluar në shekullin e 12-të. Shumë shkrimtarë të famshëm kanë studiuaraty, duke e përfshirë J.R.R. Tolkien, C.S. Lewis dhe Oscar Wilde. Oksfordi e ka një sistem unik të kolegjeve, ku studentët jetojnë dhe studiojnë në komunitete më të vogla brenda universitetit. Universiteti është i njohur për ceremonitë e veta tradicionale, si ceremonia e diplomimit me fustane dhe kapele të veçanta zyrtare.**

***Universitetet rangohen në bazë të kritereve të ndryshme që mund të ndryshojnë varësisht nga burimi dhe metodologjia e rangimit. Disa nga faktorët e zakonshëm që merren parasysh gjatë rangimit të universiteteve janë:***

***Reputacioni akademik:*** *Vlerësohet cilësia e stafit mësimdhënës, rezultatet e kërkimit dhe botimet shkencore të universitetit. Ky vlerësim shpesh bëhet përmes anketave që realizohen në mesin e profesorëve, studiuesve dhe ekspertëve në fusha të caktuara.*
***Cilësia e kërkimit:*** *Vlerësohet produktiviteti dhe ndikimi i universitetit në fushën e kërkimit, duke e përfshirë numrin e punimeve të publikuara, citimet e studiuesve dhe angazhimin në projekte të mëdha kërkimore.*
***Studentët:*** *Shikohen faktorët si numri mesatar i aplikimeve për ulëset e disponueshme, cilësia e aplikimeve, suksesi i studentëve, norma e diplomimit, kënaqësia e studentëve dhe suksesi në karrierë pas diplomimit.*
***Cilësia e mësimdhënies:*** *Vlerësohet cilësia e mësimdhënies, duke i përfshirë marrëdhëniet në mes të mësimdhënësve dhe studentëve, metodat inovative të mësimdhënies, aksesi në burimet mësimore dhe infrastruktura.*
***Reputacioni ndërkombëtar:*** *Ekzaminohet perceptimi global i universitetit në komunitetin akademik, në mesin e punëdhënësve dhe studentëve në mbarë botën.*
***Mbështetja financiare:*** *Vlerësohet stabiliteti financiar i Universitetit, investimet në kërkime dhe infrastrukturë, disponueshmëria e bursave dhe mbështetja e studentëve.*

# LET'S GET TO KNOW TOP FIVE UNIVERSITIES IN THE WORLD

***Whether you are a student considering your future education or simply want to expand your knowledge about the world's leading universities, this journey through the academic elite will give you an insight into the excellence and diversity of education on a global level.***

*In today's society, education plays a key role in shaping and developing progressive societies. Universities have become hotbeds of intellectual progress, innovation and research that shape future generations of leaders, scientists and entrepreneurs. Among the many educational institutions around the world, certain universities stand out as top centers of academic excellence. Each of these universities carries its own unique history, academic tradition and cultural influence that makes them special in the global educational landscape. From the United States of America to the United Kingdom, these universities attract students from all over the world and create an atmosphere of intellectual diversity.*

*Each of them brings not only an outstanding academic reputation, but also a rich history of achievements, which have shaped the world in many ways. University rankings may vary depending on the source and the method used by a particular source, however these five universities hold a consistently high ranking on many international lists. They stand apart for their rich history, good reputation and influence in the academic world, but they are also the centers of innovation and numerous achievements in various fields. THOSE ARE:*

## Harvard University

*Harvard was founded in 1636 and is one of the oldest universities in the United States of America. Harvard is home to the largest university library in North America, the Harvard Library, which has over 20 million books. Many famous politicians, scientists, writers and business leaders have studied at Harvard, including former US presidents Barack Obama, John F. Kennedy and George W. Bush.*

## Stanford University

*Stanford is located in California's Silicon Valley, known for its technological development. The university was founded in 1885 and is one of the most prestigious universities in the USA. Stanford is home to Stanford Hospital, one of the most esteemed medical institutions in the US. Stanford is known for its focus on entrepreneurship and technological development. Many tech companies, such as Google, Yahoo, and Hewlett-Packard, were founded by Stanford alumni.*

## University of Cambridge

*Cambridge is one of the oldest universities in the English-speaking world, founded in 1209. Famous scientists like Isaac Newton, Charles Darwin and Stephen Hawking studied at the university. The University of Cambridge consists of 31 colleges, each with its own tradition and distinctive architecture.*

## MIT University

*MIT was founded in 1861 and is focused on science, technology, engineering and mathematics. MIT is home to the famous Dome, which has become the symbol of the university. MIT has a reputation for innovation and research. Its alumni have founded many tech startups and companies.*

## University of Oxford

*Oxford is one of the oldest universities in the world, founded in the 12th century. Many famous writers studied at the university, including J.R.R. Tolkien, C.S. Lewis and Oscar Wilde. Oxford has a unique system of colleges, where students live and study in smaller communities within the wider university. The university is known for its traditional ceremonies, such as the graduation ceremony in distinctive formal gowns and caps.*

***Universities are ranked based on different criteria that may vary depending on the source and ranking methodology. Some of the common factors considered when ranking universities include:***

***Academic reputation:*** *The quality of teaching staff, research results and scientific publications of the university are being evaluated. This assessment is often done through surveys ran among professors, researchers and experts in certain fields.*
***Research quality:*** *The productivity and impact of the university in the field of research is assessed, including the number of published papers, citations of researchers and engagement in major research projects.*
***Students:*** *Factors such as average number of applications per available place, quality of applications, student success, graduation rate, student satisfaction and career success after graduation are looked at.*
***Quality of teaching:*** *The quality of teaching is evaluated, including the relationship between teachers and students, innovative teaching methods, access to learning resources and infrastructure.*
***International reputation:*** *The global perception of the university in the academic community, among employers and students around the world is examined.*
***Financial support:*** *The University's financial stability, investment in research and infrastructure, availability of scholarships and student support are assessed.*





# SI TA BËJMË NJË ÇANTË UNIKE TË LAPSAVE PËR SHKOLLË?

*Shkolla ka nisur dhe çdo ditë rrugët vërshohen nga nxënësit. Keni lëndë të reja, libra, orë mësimore, njësi mësimore, detyra shtëpie... Mund ta bëni kthimin tuaj në shkollë më interesant dhe kreativ vetëm me pak imagjinatë! Këtu do t'ju sugjerojmë se si ta bëni kompletin e mjeteve shkollore më origjinal dhe impresiv! Kësaj radhe vendosëm për çantën e lapsave, e cila sigurisht është një mjet i rëndësishëm për shkollë.*

## Materiali i nevojshëm

- Një copë pëlhure më e trashë (pëlhurë plisi)
- Bisturi
- Shirit dekorativ
- Çfarëdolloj butona kapës.



Çanta për lapsa ju mundëson që t'i mbani në një vend mjetet shkollore, si lapsat, gomat, vizoret, ngjyrat e drurit dhe gjërat e tjera të vogla. Kjo e bën më të lehtë qasjen në ato gjësende pa pasur nevojë që të gërmoni nëpër xhepa ose nëpër çantë. Gjithashtu, çanta e lapsave siguron mbrojtje për mjetet shkollore nga ndikimet e jashtme. Pëlhura e çantës së lapsave i mbron majet e lapsave nga thyerja dhe shiriti 'velcro' (me ngjitës) bën që mjetet shkollore të mos bien e të humbasin. Një avantazh tjetër i çantës së lapsave është se është kompakte dhe portative dhe ju mundëson që t'i bartni me lehtësi ata aksesorë shkollor nga një vend në tjetrin. Mund ta futni në çantë dhe ta merrni me vete në shkollë, në orë mësimore apo në ndonjë aktivitet tjetër.

Lexoni më poshtë për të mësuar se si ta bëni një çantë unike të lapsave pa pasur nevojë për qepje, por në një mënyrë të thjeshtë dhe të lehtë.

### *Procesi i krijimit:*

1. Në fillim, le t'ju themi se një nga avantazhet e realizimit të kësaj mbajtëseje të lapsave është se nuk keni nevojë të jeni fare profesionist në rrobaqepësi, pasi që duhet vetëm të preni. Fillimisht, me bisturi priteni disa herë në mes copën e materialit, me ndihmën e një vizoreje, në mënyrë që të fitoni shirita me përmasa të barabarta.
2. Më pas duhet t'i vendosni butonat kapës në cepat e jashtëm të mbajtëses siç tregohet në foto.
3. Pastaj radhitni lapsat pranë njëri-tjetrit në shirita.
4. Tani që i keni rregulluar lapsat, mbështilleni mbajtësen si një petull.
5. Përdorni shiritin dekorativ për ta lidhur në mënyrë që të mos hapet vazhdimisht dhe të duket edhe më bukur.

1



2



3



4



Me kaq, mbajtësja juaj unike e lapsave është gati. Shpejtë, lehtë dhe bukur! Ju urojmë argëtim teksa e punoni këtë mbajtëse të lapsave dhe kënaqësi duke e përdorur!

Kjo mbajtëse e lapsave e thjeshtë dhe minimaliste por shumë unike dhe do të tërheqë vëmendjen e të gjithëve, gjë që do t'ju kënaqë edhe më shumë kur ta përdorni.

Gjithashtu, ju mund ta personalizoni atë me ngjyra, dekorime, ngjitëse ose emrin tuaj, gjë që do ta bëjë mbajtësen tuaj edhe më unike dhe të dallueshme.

.

*Kthejeni mësimin në argëtim!*





DO IT YOURSELF

# HOW TO MAKE A UNIQUE PENCIL CASE FOR SCHOOL?

*School has started and every day the streets are flooded with schoolchildren. You have new subjects, books, classes, lessons, homework... You can make your return to school more interesting and creative with just a little imagination! Therefore, we have a suggestion on how you can make your school supplies – original and memorable! This time we decided to go for a pencil case, which is certainly an important item for school.*

## Material needed

- a piece of harder material (for example felt)
- scalpel
- decorative tape
- and snap buttons of any kind.

*A pencil case allows you to keep your school supplies, such as pencils, erasers, rulers, crayons, and other small things, in one place. This makes it easier to access certain supplies without searching pockets or bags. Also, a pencil case provides protection for your school supplies from external influences. The fabric of the pencil case protects the sharp edges of pencils from breaking, and the zipper prevents the supplies from falling out or getting lost. Another advantage of a pencil case is that it is compact and portable and allows you to easily carry your school supplies from one place to another. You can put it in your bag or backpack and take it with you to school, classes, or any other activity.*

*Read on to find out how to make a unique pencil case for school without sewing, in a simple and easy way.*



### *The making process:*

*1. At the beginning, let us tell you that one of the advantages of making this pencil case is that you don't need to be a sewing professional at all, you just need to chop. First, cut the piece of material in the middle with a scalpel several times, with the help of a ruler, so that you get equal-sized strips.*
*2. Then you need to attach the snap buttons to the outside of the pencil case as shown in the picture.*
*3. Next, you can arrange your pencils next to each other on the strips.*
*4. Now that you have arranged the pencils, it is necessary to roll the pencil case like a pancake.*
*5. Use the decorative tape to tie it so that it doesn't keep opening and it looks even more beautiful.*

*And that's it, your unique pencil case is ready. Fast, easy, and beautiful! Have fun making this pencil case and enjoy using it! This simple minimalist but very unique pencil case will catch everyone's eye and you will be even more pleased to use it. Also, you can personalize it with colors, decorations, stickers, or your name, which certainly makes the pencil case unique and recognizable.*
*Make learning fun!*




1


2


3


4

# KREMTIMI I KINEMASË SË PAVARUR: **FESTIVALI I FILMIT "SUNDANCE"**

*Çdo vit, industria e filmit mblidhet në qytetin piktoresk Park Siti, Jutah, për të kremtuar krijimtarinë, tregimin dhe kinemanë e pavarur. Festivali i Filmit "Sundance", i themeluar nga Robert Redford në vitin 1978, është shndërruar në një nga festivalet më prestigjioze dhe më me ndikim të filmit në botë.*




### Angazhimi ndaj kinemasë së pavarur

Kjo ngjarje vjetore, me kohëzgjatje mbi dhjetë ditë çdo janar, shfaq një përzgjedhje të larmishme filmash që provokojnë mendime, janë nismë e karrierës së kineastëve të rinj, si dhe e kultivon një komunitet të gjallë artistësh dhe entuziastësh të filmit. Festivali i Filmit "Sundance" është i njohur për angazhimin e tij ndaj kinemasë së pavarur, duke ofruar një platformë për kineastët ku ata mund t'i ndajnë vizionet dhe zërat e tyre unik me një audiencë globale. Nga dokumentarët magjepsës dhe narrativat inovative deri tek filmat eksperimentalë dhe përvojat e realitetit virtual, programet e festivalit e pasqyrojnë spektrin e gjerë të artit kinematografik.

### Zbulimi dhe edukimi i talentëve të rinj

Një nga karakteristikat përcaktuese të festivalit është theksi i tij te zbulimi. "Sundance" e ka një histori të zbulimit të thesarve të çmuar të fshehur dhe fillimit të karrierave. Filmat ikonë si "Reservoir Dogs", "Little Miss Sunshine" dhe "Whiplash" të gjithë debutuan në "Sundance", duke i vendosur regjisorët përkatës, Quentin Tarantino, Jonathan Dayton, Valerie Faris dhe Damien Chazelle, në qendër të vëmendjes. Përkushtimi i festivalit për të kultivuar talentët e rinj e ka luajtur një rol jetik në formësimin e peizazhit të kinematografisë bashkëkohore.



### Sundance Labs

Ngjarjet më të pritura të festivalit janë "Sundance Labs", të cilët ofrojnë një mjedis mbështetës për kineastët për të zhvilluar projektet e tyre. Laboratorët u ofrojnë filmbërësve mentorim, burime dhe informata kthyese të çmueshme nga profesionistë me përvojë. Ky mjedis edukativ e inkurajon marrjen e rrezikut dhe eksperimentimin, duke u mundësuar kineastëve të shtyjnë kufijtë dhe të eksplorojnë teknika të reja të tregimit të ngjarjeve.

### Promovimi i zërave dhe tregimeve të padëgjuara

Festivali i Filmit "Sundance" nuk është thjesht një kremtë e kinemasë; është gjithashtu një platformë për avancimin e bisedave të rëndësishme sociale dhe kulturore. Festivali e ka një histori të gjatë të promovimit të zërave dhe historive të ndryshme që shpesh nuk dëgjohen në kinemanë kryesore. "Sundance" ka qenë instrumental në nisjen e karrierës së kineastëve të nënpërfaqësuar, duke i përfshirë gratë, njerëzit me ngjyrë dhe anëtarët e komunitetit LGBTQ+. Përmes filmave të tyre, këta artistë hedhin dritë mbi çështjet aktuale sociale, i sfidojnë narrativat mbizotëruese dhe e ndezin dialogun kuptimplotë.

### Programi "Sundance New Frontier"

Gjatë viteve të fundit, festivali e ka përqafuar edhe teknologjinë dhe mediat e reja. Programi "Sundance New Frontier" shfaq vepra inovative që eksperimentojnë me tregime

gjithëpërfshirëse, realitet virtual, realitet të shtuar dhe mediume të tjera të reja. Ky eksplorim i kryqëzimit midis artit dhe teknologjisë i shtyn kufijtë e krijimit të filmave tradicionalë dhe e ofron një platformë për përvoja novatore të tregimit.

### *Ndikimi i "Sundance"*

Ndikimi i Festivalit të Filmit "Sundance" shtrihet shumë përtej kohëzgjatjes së tij dhjetëditore. Filmat që shfaqen premierë në "Sundance"shpesh marrin vlerësime nga kritikët, fitojnë çmime dhe marrëveshje të sigurta shpërndarjeje, duke siguruar që këta zëra të pavarur të arrijnë një audiencë më të gjerë. Ndikimi i festivalit në industrinë e filmit nuk mund të mbithekësohet, pasi ai vazhdon të mbrojë kineastët e pavarur, të frymëzojë kreativitetin dhe të formësojë të ardhmen e kinemasë.

### *Një eksperiencë e paharrueshme*

Për entuziastët e filmit dhe profesionistët e industrisë, pjesëmarrja në Festivalin e Filmit "Sundance" është një përvojë e paharrueshme. Nga energjia dhe emocioni i dukshëm në ajër deri tek mundësia për të zbuluar filma novatorë dhe për t'u angazhuar me artistë vizionarë, "Sundance" e ofron një kremtë unike dhe gjithëpërfshirëse të artit të kinemasë.

**Shtëpi e lirisë artistike, diversitetit dhe e tregimit të pavarur**
Ndërsa Festivali i Filmit "Sundance" vazhdon të evoluojë dhe të përshtatet me peizazhin gjithnjë në ndryshim të industrisë së filmit, ai mbetet i përkushtuar ndaj vlerave të tij thelbësore të lirisë artistike, diversitetit dhe tregimit të pavarur. Ai vazhdon të jetë një fener frymëzimi, duke e pasur në qendër të vëmendjes fuqinë e kinemasë për të argëtuar, edukuar dhe për të provokuar mendimin.

# CELEBRATING INDEPENDENT CINEMA: **THE SUNDANCE FILM FESTIVAL**

***Every year, the film industry converges in the picturesque town of Park City, Utah, for a celebration of creativity, storytelling, and independent cinema. The Sundance Film Festival, founded by Robert Redford in 1978, has become one of the most prestigious and influential film festivals in the world.***

### *Commitment to Independent Cinema*

Spanning over ten days each January, this annual event showcases a diverse selection of thought-provoking films, launches the careers of emerging filmmakers, and fosters a vibrant community of artists and film enthusiasts. The Sundance Film Festival is renowned for its commitment to independent cinema, providing a platform for filmmakers to share their unique visions and voices with a global audience. From compelling documentaries and innovative narratives to experimental films and virtual reality experiences, the festival's programming reflects the wide spectrum of cinematic artistry.

### *Discovering and Nurturing Emerging Talent*

One of the festival's defining characteristics is its emphasis on discovery. Sundance has a track record of unearthing hidden gems and launching careers. Iconic films like "Reservoir Dogs," "Little Miss Sunshine," and "Whiplash" all made their debut at Sundance, propelling their respective directors, Quentin Tarantino, Jonathan Dayton, Valerie Faris, and Damien Chazelle, into the spotlight. The festival's dedication to nurturing emerging talent has played a vital role in shaping the landscape of contemporary filmmaking.

### *Sundance Labs*

The festival's most anticipated events are the Sundance Labs, which provide a supportive environment for filmmakers to develop their projects. The Labs offer filmmakers invaluable mentorship, resources, and feedback from experienced professionals. This nurturing environment encourages risk-taking and experimentation, allowing filmmakers to push boundaries and explore new storytelling techniques.

### *Promoting Unheard Voices and Stories*

The Sundance Film Festival is not just a celebration of cinema; it is also a platform for advancing important social and cultural conversations. The festival has a long history of promoting diverse voices and stories that often go unheard in mainstream cinema. Sundance has been instrumental in launching the careers of underrepresented filmmakers, including women, people of color, and members of the LGBTQ+ community. Through their films, these artists shed light on pressing social issues, challenge prevailing narratives, and spark meaningful dialogue.

### *The Sundance New Frontier Program*

In recent years, the festival has also embraced technology and new media. The Sundance New Frontier program showcases innovative works that experiment with immersive storytelling, virtual reality, augmented reality, and other emerging mediums. This exploration of the intersection between art and technology pushes the boundaries of traditional filmmaking and provides a platform for groundbreaking storytelling experiences.

### *The Sundance Influence*

The Sundance Film Festival's influence extends far beyond its ten-day duration. The films that premiere at Sundance often go on to receive critical acclaim, garner awards, and secure distribution deals, ensuring that these independent voices reach a wider audience. The festival's impact on the film industry cannot be overstated, as it continues to champion independent filmmakers, inspire creativity, and shape the future of cinema.

### *An Unforgettable Experience*

For film enthusiasts and industry professionals alike, attending the Sundance Film Festival is an unforgettable experience. From the palpable energy and excitement in the air to the opportunity to discover groundbreaking films and engage with visionary artists, Sundance offers a unique and immersive celebration of the art of cinema.

***Home to Artistic Freedom, Diversity, and Independent Storytelling***
*As the Sundance Film Festival continues to evolve and adapt to the ever-changing landscape of the film industry, it remains committed to its core values of artistic freedom, diversity, and independent storytelling. It continues to be a beacon of inspiration, shining a spotlight on the power of cinema to entertain, educate, and provoke thought.*

# AMIR RRAHMANI: YLLI NË NGRITJE NË GALAKTIKËN E FUTBOLLIT

## *Eksplorojmë udhëtimin dhe potencialin e mbrojtësit fenomenal*

***Në botën e futbollit, yjet lindin, nderohen dhe lustrohen në një skenë globale, duke i magjepsur tifozët dhe duke lënë gjurmë të pashlyeshme në lojën e bukur. Një yll i tillë në ngritje i cili vazhdimisht ka bërë bujë në galaktikën e futbollit është kush tjetër veçse Amir Rrahmani. Udhëtimi i mbrojtësit të aftë nga errësira në qendër të vëmendjes ka qenë i jashtëzakonshëm, kurse shkathtësia, vendosmëria dhe përkushtimi i tij ndaj sportit e kanë forcuar vendin e tij si lojtar për t'u parë.***





***Fillimet e hershme dhe ngjitja e vazhdueshme:***
Tregimi i Amir Rrahmanit është histori e këmbënguljes dhe e punës së palodhshme. I lindur më 24 shkurt 1994, në Kosovë, jeta e hershme e Rrahmanit u shënua nga disa sfida serioze. Pavarësisht rrethanave të trazuara, pasioni i tij për futbollin ishte i dukshëm që në moshë të re. Ai e filloi karrierën e tij rinore me klubin lokal KF Kamenica, ku talenti i tij i pashoq ra në sy të skautëve.



Shtegtimi i Rrahmanit mori një kthesë të rëndësishme kur ai iu bashkua ekipit junior të Dinamo Zagrebit, klubit të shquar kroat që njihet për edukimin e talenteve të nivelit të lartë. Koha e tij në Zagreb doli të ishte transformuese, pasi ai i përforcoi shkathtësitë e tij dhe fitoi përvojë të paçmuar. Ai u përparoi shpejt, dhe zuri vend në skuadrën e seniorëve dhe si një forcë që duhej përballur në skenën e futbollit kroat.

***Motor i mbrojtjes:***
Me shtatlartësinë 1.92 metra, Amir Rrahmani zotëron atributet fizike që e bëjnë atë një figurë imponuese në zemrën e mbrojtjes. Shkathtësia e tij në ajër, gjakftohtësia nën presion dhe aftësia për ta lexuar lojën e spikasin si një motor të vërtetë të mbrojtjes. Inteligjenca taktike dhe pozicionimi i Rrahmanit i ka dhënë atij besimin e trajnerëve dhe bashkëlojtarëve, duke e bërë atë pjesë të pandashme të skuadrave të cilat i përfaqëson.

Pasi la gjurmë në Kroaci, talentet e Rrahmanit nuk kaluan pa u vënë re edhe në skenën ndërkombëtare. Ai debutoi në kombëtaren e Kosovës në vitin 2016 dhe që atëherë është bërë një gur themeli i formacionit tonë mbrojtës. Cilësitë e tij drejtuese dhe angazhimi i pashoq në fushë i kanë dhënë atij shiritin e kapitenit, një dëshmi e ndikimit dhe respektit të tij në mesin e bashkëmoshatarëve të tij.

***Odiseja evropiane:***
Joshja nga ligat evropiane më të mira u bë realitet dhe rrugëtimi i tij e çoi në Serinë A të Italisë. Ai iu bashkua Napolit në vitin 2020, ku e përqafoi sfidën për të garuar në një nga ligat më të forta të futbollit në botë. Përshtatja e tij në lojën italiane e tregoi shkathtësinë dhe adaptueshmërinë e tij, duke e forcuar më tej reputacionin e tij si një mbrojtës i shkathtë dhe i klasit të lartë.

Performancat e Rrahmanit në Serinë A e tërhoqën vëmendjen e entuziastëve dhe ekspertëve të futbollit. Stili i tij elegant i lojës, i karakterizuar nga ndërhyrjet në kohën e duhur dhe pasimet e mirë-menduara nga prapa, e demonstruan aftësitë e tij të gjithanshme si një qendërmbrojtës modern. Ndërsa Napoli luftonte për lavdinë vendase dhe evropiane, kontributet e Rrahmanit rezultuan thelbësore në ndjekjen e suksesit.

***Perspektivat e ardhshme:***
Ndërsa Amir Rrahmani vazhdon të bëjë hapa përpara në rrugëtimin e tij futbollistik, potenciali i tij duket i pakufishëm. Shkathtësitë e tij mbresëlënëse, të kombinuara me etikën e tij të punës dhe vendosmërinë, tregojnë se ai e ka brumin e futbollistit të ndritshëm. Me çdo ndeshje, ai forcon statusin e tij si një yll në rritje në galaktikën e futbollit, duke e magjepsur audiencën dhe duke lënë gjurmë të pashlyeshme në sport.

Ndërsa fansat presin me padurim kapitujt e ardhshëm të karrierës së tij, një gjë është e sigurt: rrugëtimi i Amir Rrahmanit është një dëshmi e fuqisë së përkushtimit, talentit dhe dashurisë së palëkundur për lojën e bukur. Historia e tij shërben si një frymëzim për futbollistët aspirantë dhe një kujtesë se rruga drejt madhështisë shpesh është e shtruar me sfida dhe triumfe, të cilat e formojnë një lojtar në një yll të vërtetë.



# AMIR RRAHMANI: A RISING STAR IN THE FOOTBALL GALAXY

## Exploring the Journey and Potential of the Phenomenal Defender



***In the world of football, stars are born, honed, and polished on a global stage, captivating fans and leaving an indelible mark on the beautiful game. One such rising star who has been steadily making waves in the football galaxy is none other than Amir Rrahmani. The commanding defender's journey from obscurity to the spotlight has been a remarkable one, and his skill, determination, and dedication to the sport have solidified his place as a player to watch.***

***ARRITJE TË DUKSHME***
***Suksesi i klubit me Dinamon e Zagrebit:*** *Gjatë kohës së tij me Dinamon e Zagrebit, Rrahmani e ndihmoi klubin të arrinte suksese në 'Prva HNL' (Liga e Parë e Futbollit Kroat). Ai ishte pjesë e ekipit që i fitoi titujt e ligës dhe kupat vendase, duke treguar kontributin e tij në dominimin e klubit në futbollin kroat.*

***Përparim në nivel ndërkombëtar me Kosovën:*** *Rrahmani luajti një rol vendimtar në rrugëtimin e ekipit kombëtar të futbollit të Kosovës drejt lartësimit. Ai ishte i rëndësishëm në përpjekjet e ekipit tonë gjatë garave të ndryshme ndërkombëtare, duke i përfshirë kualifikimet për Kampionatin Evropian të UEFA-së dhe Ligën e Kombeve UEFA. Paraqitjet e tij në nivel ndërkombëtar ndihmuan në ngritjen e profilit të futbollit të Kosovës dhe forcimin e reputacionit të tij si lojtar kyç për ekipin kombëtar.*

***Kalimi te Napoli dhe kampioni i Serisë A:*** *Kalimi i Rrahmanit te Napoli në Serinë A shënoi një moment historik të rëndësishëm në karrierën e tij. Anëtarësimi në një ligë evropiane të nivelit të lartë dhe një klub prestigjioz si Napoli e demonstroi përparimin e tij si lojtar. Nënshkrimi i kontratës me Napoli e nënvizoi potencialin e tij dhe i theksoi aftësitë e tij si një qendërmbrojtës shumë i kërkuar. Kjo u përforcua më tej nga fakti se ai ishte pjesë integrale e skuadrës së Napolit që e fitoi Scudetton 2023 (kampionati italian) , një sukses që ata nuk e kishin arritur që kur Maradona luajti për ta në vitet 80-të. Sipas Transfermarkt.com vlera e tij aktuale është 25 milionë euro.*

### Early Beginnings and Steady Ascent:

Amir Rrahmani's story is one of perseverance and hard work. Born on February 24, 1994, in Kosovo, Rrahmani's early life was marked by some serious challenges. Despite the tumultuous circumstances, his passion for football burned bright from a young age. He began his youth career with local club KF Kamenica, where his raw talent caught the eye of scouts.

Rrahmani's journey took a significant turn when he joined the youth setup of Dinamo Zagreb, the prominent Croatian club known for nurturing top-tier talent. His time in Zagreb proved to be transformative, as he honed his skills and gained invaluable experience. He quickly climbed the ranks, earning a spot in the senior squad and establishing himself as a force to be reckoned with in the Croatian football scene.

### Defensive Dynamo:

Standing tall at 1.92 meters, Amir Rrahmani possesses the physical attributes that make him an imposing figure in the heart of defense. His aerial prowess, composure under pressure, and ability to read the game set him apart as a true defensive dynamo. Rrahmani's tactical intelligence and positioning have earned him the trust of his coaches and teammates alike, making him an integral part of the teams he represents.

After making his mark in Croatia, Rrahmani's talents did not go unnoticed on the international stage. He made his debut for the Kosovo national team in 2016 and has since become a cornerstone of our defensive lineup. His leadership qualities and unwavering commitment on the pitch have earned him the captain's armband, a testament to his influence and respect among his peers.

### European Odyssey:

The allure of top-flight European leagues beckoned, and his journey led him to Italy's Serie A. Joining Napoli in 2020, he embraced the challenge of competing in one of the most demanding football leagues in the world. His adaptation to the Italian game showcased his versatility and adaptability, further solidifying his reputation as a versatile and top-class defender.

Rrahmani's performances in Serie A drew the attention of football enthusiasts and pundits alike. His elegant style of play, characterized by well-timed tackles and composed distribution from the back, demonstrated his all-around abilities as a modern center-back. As Napoli vied for domestic and European glory, Rrahmani's contributions proved pivotal in their pursuit of success.

### Future Prospects:

As Amir Rrahmani continues to make strides in his football journey, his potential seems boundless. His impressive skill set, combined with his work ethic and determination, suggests that he has the makings of a footballing luminary. With each passing game, he cements his status as a rising star in the football galaxy, captivating audiences and leaving an indelible mark on the sport.

As fans eagerly anticipate the next chapters of his career, one thing is certain: Amir Rrahmani's journey is a testament to the power of dedication, talent, and the unwavering love for the beautiful game. His story serves as an inspiration to aspiring footballers and a reminder that the path to greatness is often paved with challenges and triumphs, all of which shape a player into a true star.

***NOTABLE ACHIEVEMENTS***
***Club Success with Dinamo Zagreb:***
*During his time with Dinamo Zagreb, Rrahmani helped the club achieve domestic success in the Croatian Prva HNL (Croatian First Football League). He was part of the team that won league titles and domestic cups, showcasing his contribution to the club's dominance in Croatian football.*

***International Breakthrough with Kosovo:*** *Rrahmani played a crucial role in Kosovo national football team's journey to prominence. He was instrumental in our team's efforts during various international competitions, including UEFA European Championship qualifiers and the UEFA Nations League. His performances at the international level helped raise the profile of Kosovo football and solidified his reputation as a key player for the national team.*

***Move to Napoli and Serie A Champion:*** *Rrahmani's move to Napoli in Serie A marked a significant milestone in his career. Joining a top-tier European league and a prestigious club like Napoli demonstrated his progression as a player. His signing by Napoli underscored his potential and highlighted his abilities as a highly sought-after central defender. This has been further solidified by the fact that he was an integral part of the Napoli team that won the 2023 Scudetto (Italian Championship), a feat they have not managed since Maradona played for them in the 1980's. According to Transfermarkt.com his current value is Euro 25 million.*

# SYZET ZMADHUESE INTELIGJENTE TË APPLE PËR EKSPLORIM: *ÇKA DIMË DERI TASH?*




***Syzet e Apple kanë qenë objekt spekulimesh për disa kohë dhe ndërsa detajet janë ende të kufizuara, potenciali për këto syze zmadhuese inteligjente të Apple për të ripërcaktuar kompjuterin bashkëkohor e ka kapur imagjinatën e entuziastëve të teknologjisë. Edhe pse prezantimi zyrtar është disa vite larg, zhvillimet e fundit rreth kufjeve Apple Vision Pro japin sugjerime se çfarë mund të presim nga syzet e ardhshme të Apple.***

### Spekulimet për datën e nxerrjes në treg: durimi është shumë i rëndësishëm

Për fat të keq, duket se kemi për të pritur mjaft shumë derisa syzet Apple të dalin në treg. Prezantimi i fundit i kufjeve Vision Pro VR/AR në WWDC 2023 (Apple Worldwide Developers Conference) krijoi entuziazëm, por syzet Apple nuk u përmendën. Disa analistë parashikojnë një datë të mundshme të nxjerrjes në treg në vitin 2026, duke marrë parasysh afatin kohor të prodhimit për meta-lentet e avancuara që pritet të jenë një përbërës kyç. Megjithatë, disa e ofrojnë një perspektivë më optimiste, duke sugjeruar një datë të mundshme deri në fund të vitit 2025.

### Çmimet e mundshme: qasje e përballueshme

Spekulimet rreth çmimit të syzeve Apple kanë qarkulluar, me zëra që sugjerojnë një pikë çmimi prej 499 dollarësh (pa i përfshirë tarifat e porosisë). Krahasuar me kufjet zmadhuese konkurruese si Microsoft Hololens 2 ose Vision Pro i vetë Apple, ky çmim duket relativisht i ulët. Meqenëse syzet Apple do të mbështeten në një iPhone shoqërues për përpunim, ato do të kenë më pak pjesë dhe më pak kompleksitet se kufjet e pavarura. Kjo qasje është e ngjashme me syzet inteligjente Vuzix Blade, të cilat vijnë me një kamerë të integruar dhe integrimin Alexa. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto spekulime të çmimeve janë subjekt i ndryshimit pasi të ketë më shumë informacione.

### Veçoritë dhe aftësitë: zgjerimi i mundësive

Syzet Apple pritet të ofrojnë informata direkt nga telefoni juaj në ekranin tuaj të shikimit, duke u sinkronizuar me iPhone tuaj për të shfaqur tekste, email, harta, lojëra, e shumë gjëra të tjera. Apple planifikon të mbështesë aplikacionet e palëve të treta dhe mund të prezantojë një dyqan të dedikuar aplikacionesh, të ngjashëm me ekosistemet Apple TV dhe Apple Watch. Patentat sugjerojnë që syzet Apple mund të përshtaten automatikisht për njerëzit me shikim të dobët, duke e eliminuar kështu nevojën për lente me porosi. Një tjetër patentë intriguese lë të kuptohet për një sistem të bazuar në projeksion që transmeton imazhe drejtpërdrejt në syrin e përdoruesit, duke e hequr nevojën për një ekran transparent.

### Dizajni dhe komoditeti: përzierja e stilit dhe e funksionit

Raportet tregojnë se prototipi aktual i syzeve të Apple përmban një palë syze plastike të pakuptimta, me materiale marketingu që sugjerojnë një dizajn që të kujton syzet e Clark Kent (aka Superman). Syzet vijnë me një skaner LiDAR (Light Detection and Ranging) në pjesën e djathtë, ndërsa shqetësimet për privatësinë kanë çuar në përjashtimin e kamerave shtesë. Apple synon të krijojë një dizajn të rehatshëm të përshtatshëm për përdorim të përditshëm, megjithëse syzet mund të mos jenë aq të lehta sa





syzet e diellit të modës. Aktualisht, nuk ka plane për variacione të ngjyrosura, por me zhvillimin e produktit, Apple mund të zgjerojë ofertat e tij për të përfshirë stile të ndryshme.

### Privatësia dhe Patentat: mbrojtja e përvojës së përdoruesit

Apple ka eksploruar në mënyrë aktive qasje të ndryshme për të siguruar privatësi dhe transparencë në lidhje me aftësitë e regjistrimit të Apple Glasses. Patentat sugjerojnë opsione të tilla si modulet e lëvizshme të kamerës, dritat që tregojnë statusin e regjistrimit dhe modelet e enkriptimit për të çaktivizuar regjistrimin kur nuk plotësohen kushtet specifike. Angazhimi i Apple për të mbrojtur privatësinë e përdoruesve dhe adresimin e shqetësimeve në lidhje me regjistrimin në hapësirat publike është i dukshëm në dosjet e tyre të patentave.

*Duke pritur me padurim të ardhmen e syzeve Apple*

*Ndërsa prezantimi zyrtar i syzeve Apple është ende disa vite larg, thashethemet dhe patentat e ofrojnë një paraqitje të shkurtër të potencialit të këtyre syzeve inteligjente futuriste. Me përzierjen e tyre të aftësive zmadhuara, dizajnit elegant dhe veçorive të fokusuara në privatësi, syzet Apple e kanë potencialin për të revolucionarizuar teknologjinë bashkëkohore. Ndërsa presim me padurim më shumë informacion, është e qartë se Apple po punon me zell për të krijuar një produkt bindës dhe inovativ që integrohet pa probleme me jetën tonë dixhitale.*

# EXPLORING APPLE'S AUGMENTED REALITY SMART GLASSES: *WHAT WE KNOW SO FAR?*

***Apple Glasses have been a subject of speculation for some time, and while details are still limited, the potential for these augmented reality smart glasses to redefine wearable computing has captured the imagination of tech enthusiasts. Although the official launch is still a few years away, recent developments surrounding the Apple Vision Pro headset provide hints about what we can expect from the future Apple Glasses.***

### Release Date Speculations: Patience is Key

Unfortunately, it appears that we have a significant wait ahead before the Apple Glasses hit the market. The recent unveiling of the Vision Pro VR/AR headset at WWDC 2023 (Apple Worldwide Developers Conference) generated excitement, but there was no mention of the Apple Glasses. Some analysts predict a potential release in 2026, considering the production timeline for the advanced metalenses that are expected to be a key component. However, others offer a more optimistic outlook, suggesting a potential release by the end of 2025.

### Price Expectations: Affordable Accessibility

Speculations about the price of Apple Glasses have been circulating, with rumors suggesting a price point of $499 (excluding prescription fees). Compared to competing augmented reality headsets like the Microsoft Hololens 2 or Apple's own Vision Pro, this price seems relatively low. Since the Apple Glasses will rely on a companion iPhone for processing, they will have fewer parts and less complexity than standalone headsets. This approach is similar to the Vuzix Blade smart glasses, which come with a built-in camera and Alexa integration. However, it's important to note that these price speculations are subject to change as more information becomes available.

### Features and Capabilities: Expanding Possibilities

Apple Glasses are expected to bring information from your phone directly into your field of vision, synchronizing with your iPhone to display texts, emails, maps, games, and more. Apple plans to support third-party apps and may introduce a dedicated app store, similar to the Apple TV and Apple Watch ecosystems. Patents suggest that Apple Glasses may automatically adjust for people with poor eyesight, potentially eliminating the need for prescription lenses. Another intriguing patent hints at a projection-based system that beams images directly into the user's eye, removing the necessity for a transparent display.

### Design and Comfort: Blending Style and Function

Reports indicate that the current Apple Glasses prototype features an unassuming pair of plastic glasses, with marketing materials suggesting a design reminiscent of Clark Kent's (aka Superman) glasses. The glasses come with a LiDAR (Light Detection and Ranging) scanner on the right temple, while privacy concerns have led to the exclusion of additional cameras. Apple aims to create a comfortable design suitable for everyday use, although the glasses may not be as lightweight as fashion sunglasses. Currently, there are no plans for tinted variations, but as the product evolves, Apple may expand its offerings to include different styles.

### Privacy and Patents: Protecting User Experience

Apple has been actively exploring various approaches to ensure privacy and transparency regarding the recording capabilities of Apple Glasses. Patents suggest options such as removable camera modules, lights indicating recording status, and encryption patterns to disable recording when specific conditions are not met. Apple's commitment to protecting user privacy and addressing concerns about recording in public spaces is evident in their patent filings.

*Eagerly Awaiting the Future of Apple Glasses*

*While the official release of Apple Glasses is still a few years away, the rumors and patents provide a glimpse into the potential of these futuristic smart glasses. With their blend of augmented reality capabilities, sleek design, and privacy-focused features, Apple Glasses have the potential to revolutionize wearable technology. As we eagerly await more information, it's evident that Apple is diligently working to create a compelling and innovative product that seamlessly integrates with our digital lives.*

# DOKUFEST DHE PROJEKTI “SI TË SHOH TY” -
## *LIDHJA PËRMES ARTIT DHE KULTURËS NË BALLKAN*

***Çdo gusht, në zemër të Ballkanit, qyteti i Prizrenit bëhet qendër globale për filmin dhe muzikën. Kjo është koha kur mbahet “DokuFest”, Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër, i cili me krenari mban titullin e festivalit më të madh të filmit në Kosovë. “DokuFest” është shumë më tepër se një festival i thjeshtë. Ai është një eksperiencë, një shkrirje e artit, kulturës, edukimit dhe argëtimit që tërheq entuziastë të filmit, artistë dhe vizitorë nga e gjithë bota. Njihet si një nga ngjarjet më të mira të filmit dhe muzikës në Evropën Juglindore, prandaj tërheq vëmendjen me përzgjedhjen e tij të larmishme dhe cilësore të filmave të shkurtër.***




Ismail Murseli dhe Milica Brzakoviq

Megjithatë, “DokuFest” nuk është vetëm një festival filmi. Ai ofron një program të pasur dhe të larmishëm, duke përfshirë ekspozita fotografike dokumentare, debate, punëtori, dhe koncerte. Atmosfera gjatë festivalit është



Zana Arapi Xheladini

unike – rrugët e Prizrenit janë të mbushura me vizitorë, artistë dhe muzikantë, dhe i gjithë qyteti bëhet një skenë arti. “DokuFest” është më shumë se një ngjarje - është një dukuri kulturore, një simbol i unitetit dhe krijimtarisë. Rëndësia e tij shkon përtej kufijve të artit dhe filmit, duke lënë gjurmë të pashlyeshme dhe një rrugë drejt të kuptuarit, frymëzimit dhe ndryshimit.

Zana Arapi Xheladini, menaxhere e Projektit “Si të shoh ty”, ndau me Revistën “4You” një rrëfim frymëzues për një projekt trevjeçar që u realizua në bashkëpunim me “DokuFest”, fondin “B92” dhe Festivalin “Free Zone” në Serbi dhe u financua nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Projekti që ka filluar në vitin 2020 e ka në thelb organizimin e katër kampeve ndërkulturore, me qëllim të ndërlidhjes së të rinjve nga Kosova dhe Serbia. Në kuadër të këtyre kampeve u organizuan ekspozita dhe punëtori, duke krijuar kështu hapësirën për dialog dhe shkëmbim ndërmjet pjesëmarrësve. “‘DokuFest’ është pika qendrore e projektit, me organizimin e kampeve dhe ekspozitave si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Pjesëmarrësit patën mundësinë të lidhen, të ndajnë përvoja dhe të krijojnë video-portrete të bashkëmoshatarëve të tyre. Ky shkëmbim kreativ kontribuoi në identifikimin e pikave të përbashkëta dhe përhapjen e mirëkuptimit mes të rinjve,” na tregoi Xheladini. Ajo shtoi se arti dhe kultura janë dëshmuar se janë mjete të fuqishme për tejkalimin e paragjykimeve. Sipas saj, Projekti “Si të shoh ty” është një pikë e ndritur në Ballkan, që e tregon rëndësinë e një qasjeje krijuese për arritjen e paqes dhe bashkëpunimit mes komuniteteve.



### Lidhja përmes dialogut dhe mirëkuptimit

Fjolla Muharemi është me origjinë nga Mitrovica, por aktualisht jeton në Londër. Ajo është pjesëmarrëse në Projektin “Si të shoh ty”. Ajo e theksoi përvojën e saj të të jetuarit jashtë vendit, ku është mësuar të ndërveprojë me njerëz të prejardhjeve dhe kulturave të ndryshme. Përmes pjesëmarrjes në këtë projekt, Fjolla pati rastin të bisedojë me bashkëmoshatarët e saj nga Serbia, të dëgjojë rrëfimet e tyre dhe të thyejë paragjykimet që shpesh janë prezente në media. “Arti nuk ka kufij. Na bashkon dhe na mëson të respektojmë dhe pranojmë njëri-tjetrin. “DokuFest” është një mundësi e shkëlqyer për të takuar njerëz të rinj dhe për të pasur një përvojë ndëretnike”, tha ajo. Për të, Projekti “Si të shoh ty” e hapi derën për një dialog të hapur, ku të rinjtë mund të flasin pa gjykime dhe të krijojnë hapësirë për mirëkuptim dhe tolerancë.

### Rrugët drejt të kuptuarit më të mirë

Ashtu si Fjolla, edhe Ismail

Murseli i ndau mendimet e tij mbi artin dhe kulturën dhe fuqinë e tyre për të transformuar shoqërinë për mirë me Revistën “4You”. Ai e theksoi rëndësinë e tregimit të përvojave dhe komunikimit si elemente kyçe për reduktimin e distancës mes njerëzve. Ai na tha se pjesëmarrja në një ngjarje si “DokuFest” ia ka pasuruar jetën, duke i mundësuar të takohet me njerëz nga komunitete të ndryshme. “Dialogu, ndarja e tregimeve dhe mirëkuptimi i ndërsjellë janë hapa kyçë drejt krijimit të një shoqërie më të shëndetshme dhe më të lidhur. Arti na bashkon dhe na mëson për respektin dhe pranimin reciprok”, nënvizoi Murseli.

*Zbulimi i bukurisë së artit dhe miqësisë*

*Edhe Millica Brzakoviq nga Beogradi e ndau me ne entuziazmin e saj për pjesëmarrjen në këtë projekt. Ajo theksoi se pikëpamjet e saj kanë ndryshuar përmes ndërveprimit me njerëzit dhe largimit nga narrativat mediatike dhe politika. Në vend të kësaj, ajo u fokusua në art dhe film si një mjet për të shprehur ndjenjat, problemet dhe opinionet. Përvoja e saj në “DokuFest”, ku takoi njerëz me prejardhje të ndryshme dhe ndjeu fuqinë e komunitetit, konfirmon më tej fuqinë e artit dhe kulturës në bashkimin e njerëzve dhe të mësuarit për respektin reciprok. Prandaj, ajo u tha të rinjve që t'u qasen njerëzve me zemër të hapur, duke theksuar vlerën e besimit në botën që i rrethon.*

*“Porosia ime për të rinjtë është të jenë të guximshëm e kureshtarë dhe të jenë më të butë me të tjerët, më të butë me veten dhe t'u qasen njerëzve me zemër të hapur, si dhe të kenë më shumë besim në botën që i rrethon”, tha Brzakoviq. Me këtë mesazh, ajo na kujton rëndësinë e sinqeritetit, guximit dhe besimit për të kontribuuar në mbështetjen e një bote më të mirë dhe më të shumëllojshme, dhe ne u bindëm edhe vetë në Prizren, gjatë “DokuFestit”, se një botë e tillë mund të ekzistojë vërtet.*

Na vizitoni në:
Visit us at:

# DOKUFEST AND “HOW I SEE YOU” PROJECT - *CONNECTION THROUGH ART AND CULTURE IN THE BALKANS*

***Every year in August, in the heart of the Balkans, the city of Prizren becomes the global film and music hub. This is the time when DokuFest, International Festival of Documentary and Short Films, which proudly holds the title of the largest film festival in Kosovo, takes place. DokuFest is much more than just an ordinary festival. It is an experience, a fusion of art, culture, education, and entertainment that attracts film enthusiasts, artists, and visitors from all over the world. It has been recognized as one of the top film and music events in southeast Europe, therefore it draws attention with its diverse and high-quality selection of short films.***

Nevertheless, DokuFest is not just a film festival. It features a rich and diverse program, including documentary photography exhibitions, debates, workshops, concerts. There is a unique atmosphere during the festival – Prizren's streets are flooded with visitors, artists and musicians, and the entire city becomes an art scene. DokuFest is more than an event - it is a cultural phenomenon, a symbol of unity and creativity. Its importance goes beyond the boundaries of art and film, leaving an indelible mark and a path towards understanding, inspiration and change.

Zana Arapi Xheladini, manager of the “How I See You” project, shared with the 4You Magazine an inspiring story about a three-year project that was implemented in cooperation with the DokuFest, the B92 fund and the Free Zone Festival in Serbia, which was funded by the European Union Office in Kosovo.

The project that began in 2020 has at the heart four intercultural camps, organized with the aim of connecting young people from Kosovo and Serbia. Exhibitions and workshops were organized as part of these camps, thereby creating the space for dialogue and exchange between the participants. Xheladini stated, “DokuFest is the focal part of the project, with the organization of camps and exhibitions both in Kosovo and in Serbia. The participants had the opportunity to connect, share experiences and create video portraits of their peers. This creative exchange helped identify the common points and spread understanding between the youth.” She added that art and culture have proven to be powerful tools for overcoming prejudices. According to her, the “How I See You” project is a bright spot in the Balkans, which indicates the importance of a creative approach to achieving peace and cooperation between the communities.

## Connecting through dialogue and understanding

Fjolla Muharremi is a native of Mitrovica, but she currently lives in London. She is a participant of the “How I See You” project. She highlights her experience of living abroad, where she is accustomed to interacting with people of different backgrounds and cultures. Through participation in this project, Fjolla had the opportunity to speak with her peers from Serbia, to hear their stories and to disregard the prejudices that are often present in the media. “Art has no boundaries. It brings us together and teaches us to respect and accept each other. DokuFest is a great opportunity to meet new people and have an inter-ethnic experience,” she said. For her, the “How I See You” project opened the door to an open dialogue, where young people can talk without judgment and create space for understanding and tolerance.

## Roads towards better understanding

Like Fjolla, Ismail Murseli also shared with the 4You Magazine his thoughts on art and culture and their power to transform the society for the better. He highlights the importance of telling stories and communicating as key elements for reducing the distance between people. He told us that participating in an event like DokuFest has enriched his life, allowing him to meet people from different communities. Murseli underscored that “Dialogue, sharing stories and mutual understanding are key steps towards creating a healthier and more cohesive society. Art brings us together and teaches us about mutual respect and acceptance.”

*Discovering beauty of art and friendship*

*Milica Brzakovic from Belgrade also shared with us her enthusiasm for participating in this project. She noted that her attitudes have changed through interaction with people and moved away from media narratives and politics. Instead, she focused on art and film as means of expressing feelings, problems, and opinions. Her experience at DokuFest, where she met people of different backgrounds and felt the power of community, further confirms the power of art and culture in bringing people together and learning about mutual respect. Therefore, she told the youth to approach people with an open heart, emphasizing the value of trust in the world around them.*

*Brzakovic stated, “My message to young people is to be brave and to be curious and to be gentler towards others, gentler towards themselves and to approach people with an open heart, as well as to have more confidence in the world around them.” With this message, she reminds us of the importance of frankness, courage, and trust in contributing to support a better and more diverse world, and we saw for ourselves that in Prizren, during DokuFest, such a world can really exist.*

# Mendimi juaj për pemët?



## FLORIANA BAFTIAJ

**Cili është mendimi juaj për pemët?**
Pemët janë ushqime shumë të rëndësishme për organizmin e njeriut.

**Pse janë të rëndësishme pemët?**
Pemët janë të rëndësishme pasi që ato përmbajnë vitamina të shumta dhe siç e dimë konsumimi i vitaminave është tepër i rëndësishëm për forcimin e imunitetit tonë.

**Cila pemë ju pëlqen më shumë dhe pse?**
Pema ime e preferuar është molla, pasi që përpos që ka shumë vitamina ajo është edhe tepër e shijshme.

**Cila pemë ju pëlqen më pak dhe pse?**
Në përgjithësi të gjitha pemët më pëlqejnë, rrjedhimisht nuk kam ndonjë pemë që nuk më pëlqen.

**What is your opinion about fruits?**
Fruits are a very important ingredient for the human body.

**Why are they important?**
Fruits are important because they contain many vitamins and as we know the consumption of vitamins is very important for strengthening our immunity.

**What is your favourite fruit and why?**
Apples are my favourite fruit, because besides having a lot of vitamins, it is also very tasty.

**What is your least favourite fruit and why?**
In general, I like all fruits, so I don't have any fruit that I don't like.





## LEART RAMADANI

**Cili është mendimi juaj për pemët?**
Pemët janë bëjnë pjesë në ushqimet më të shëndetshme për shkak se konsumimi i tyre ndihmon në rregullimin e metabolizmit të trupit tonë si dhe përmbajnë karbohidrate dhe vitamina që e mbrojnë shëndetin tonë dhe e përmirësojnë funksionimin e organizmit.

**Pse janë të rëndësishme pemët?**
Krahas arsyeve të sipërpërmendura, pemët janë të rëndësishme pasi që konsumimi i tyre ndihmon edhe në humbjen e peshës dhe kanë vlera ushqyese shumë të larta.

**Cila pemë ju pëlqen më shumë dhe pse?**
Pema ime e preferuar është molla, pasi që përpos që është tepër e shijshme ajo i ka edhe të gjitha vlerat e nevojshme ushqyese.

**Cila pemë ju pëlqen më pak dhe pse?**
Nuk mendoj që ka ndonjë pemë të keqe. Po ashtu, mua më pëlqejnë të gjitha pemët dhe mundohem t'i konsumojë sa më shumë për shkak të vlerave të tyre ushqyese.

**What is your opinion about fruits?**
Fruits are part of the healthiest foods because their consumption helps to regulate our body's metabolism and they also contain carbohydrates and vitamins that protect our health and improve the functioning of our organism.

**Why are they important?**
In addition to the above-mentioned reasons, fruits are important because their consumption also helps in losing weight and they have very high nutritional values.

**What is your favourite fruit and why?**
My favourite fruit is the apple, because besides being very tasty, it also has all the necessary nutritional values.

**What is your least favourite fruit and why?**
I don't think there is any bad fruit. Also, I like all fruits and I try to consume them as much as possible because of their nutritional value.



**Ju lutemi na dërgoni mendimet tuaja për pemët në këtë email: magazineforyou2003@gmail.com**

# Your opinion about fruits?



## DIAMANT KABASHI

**Cili është mendimi juaj për pemët?**
Pemët janë ushqime të shëndetshme, të cilat përmbajnë vitamina të shumta për trupin e njeriut. Për këtë arsye, si edhe çdokush tjetër, mendoj se konsumimi i tyre është i domosdoshëm për të gjithë njerëzit, dhe posaçërisht për ata persona që kanë mungesë të vitaminave në trupin e tyre.

**Pse janë të rëndësishme pemët?**
Pemët janë të rëndësishme për shkak të vlerave të tyre ushqyese, ku përfshihen vitaminat dhe mineralet e ndryshme, të cilat ndihmojnë në forcimin e imunitetit të trupit tonë dhe posaçërisht trurit.

**Cila pemë ju pëlqen më shumë dhe pse?**
Është e vështirë të veçosh vetëm një pemë pasi që mua më pëlqejnë të gjitha. Gjithsesi, nëse do të më duhej të zgjidhja do të thosha që molla është pema ime e preferuar për shkak të shijes dhe vlerave të saj ushqyese.

**Cila pemë ju pëlqen më pak dhe pse?**
Në përgjithësi më pëlqejnë të gjitha pemët, por do të thosha që dardha është mbase është nga ato që e konsumojë më së rralli.

**What is your opinion about fruits?**
Fruits are healthy foods, which contain many vitamins for the human body. For this reason, like everyone else, I think that their consumption is necessary for all people, and especially for those people who lack vitamins in their body.

**Why are they important?**
Fruits are important because of their nutritional value, which includes various vitamins and minerals, which help strengthen the immunity of our body and especially the brain.

**What is your favourite fruit and why?**
It's hard to single out just one fruit as I love them all. However, if I had to choose I would say that the apple is my favourite because of its taste and nutritional value.

**What is your least favourite fruit and why?**
In general, I like all fruits, but I would say that the pear is probably the one that I consume the least.



## KLEA RAMADANI

**Cili është mendimi juaj për pemët?**
Pemët janë ushqime të shëndetshme dhe të rëndësishme për shëndetin e njeriut.

**Pse janë të rëndësishme pemët?**
Për shkak të përmbajtjes së vitaminave ato janë tejet të rëndësishme, dhe gjithashtu konsumimi i tyre ndihmon edhe në humbjen e peshës. Për shkak të vlerave të tyre ushqyese ato ndihmojnë edhe në mbrojtjen e shëndetit tonë'

**Cila pemë ju pëlqen më shumë dhe pse?**
Pema ime e preferuar është shega, pasi që ajo ka shumë vitamina si dhe është tejet e shëndetshme për të luftuar aneminë në trupin tonë.

**Cila pemë ju pëlqen më pak dhe pse?**
Për mua të gjitha pemët janë të shijshme dhe rrjedhimisht nuk mund të them që e kam ndonjë pemë që më pëlqen më pak.

**What is your opinion about fruits?**
Fruits are healthy foods and important for human health.

**Why are they important?**
Due to the content of vitamins, they are very important, and their consumption also helps in losing weight. Due to their nutritional value, they also help protect our health.

**What is your favourite fruit and why?**
My favourite fruit is pomegranate, as it has many vitamins and is very healthy to fight anemia in our body.

**What is your least favourite fruit and why?**
I like all fruits, and therefore I cannot say that I have any fruit that I like less.





**Please send us your thoughts on fruits at this email: magazineforyou2003@gmail.com**

# SFIDAT DHE MUNDËSITË TË CILAT I SJELL SHTATORI DHE VITI I RI SHKOLLOR

*Fletoret e pashkruara, lapsat shumëngjyrësh, aroma e librave të rinj dhe ajri i emocioneve – këto janë disa nga elementët karakteristik që e shënojnë fillimin e vitit të ri shkollor. Ndërsa dielli dalëngadalë dobësohet, nxënësit përballen me sfida të reja, por edhe me mundësi për rritje dhe zhvillim. Shkolla është një vend ku fitojnë njohuri, ndërtojnë miqësi dhe i formësojnë rrugët e tyre të ardhshme. Në këtë artikull do të shqyrtojmë disa nga sfidat më të zakonshme me të cilat ju, lexuesit tanë të dashur, përballeni në fillim të vitit të ri shkollor, si dhe si t'i kapërceni ato me guxim...*



Shtatori na erdhi, viti i ri shkollor filloi, shumë nga ju janë të emocionuar, ndoshta edhe pak nervoz për ndryshimet që i sjell ai. Në mënyrë që të përgatiteni sa më mirë dhe të keni sukses në muajt e ardhshëm, është e rëndësishme t'i keni parasysh disa këshilla praktike. Ju ndoshta i keni dëgjuar tashmë një milion herë nga mësimdhënësit, profesorët dhe prindërit tuaj, por edhe ne do t'i përsërisim këshillat më të çmueshme që do t'ju ndihmojnë ta përballoni vitin e ri shkollor në mënyrën më të mirë të mundshme dhe t'i shfrytëzoni të gjitha potencialet tuaja për mësim më të mirë dhe arritje më të mëdha në shkollë.




## Menaxhimi i kohës

Një nga faktorët kyç të suksesit në shkollë është menaxhimi i mirë i kohës. Krijoni një orar të aktiviteteve ditore duke e përfshirë kohën për të mësuar, për të ushtruar, për të pushuar dhe për përgjegjësitë e tjera. Planifikimi ndihmon në ruajtjen e fokusit dhe parandalimin e stresit.

## Vendosja e caqeve

Me fillimin e vitit të ri shkollor, vendosni caqe realiste për çdo lëndë ose fushë që dëshironi ta përmirësoni. Vendosja e caqeve ju ndihmon të jeni të motivuar dhe ju drejton kah progresi.

## Teknikat efektive të të nxënit

Çdo nxënës e ka mënyrën e vet të të nxënit që i përshtatet më së miri. Është e rëndësishme që të eksploroni teknika të ndryshme të të nxënit, si mbajtja e shënimeve, përdorimi i mjeteve ndihmëse vizuale, mësimi në grup, etj. Zbuloni se cila teknikë i përshtatet më mirë stilit tuaj të të nxënit dhe aplikojeni atë për ta mësuar në mënyrë efektive kurrikulën.

## Stili i shëndetshëm i jetesës

Shëndeti fizik dhe mendor janë thelbësor për suksesin në shkollë. Kujdesuni për shëndetin tuaj nëpërmjet aktivitetit të rregullt fizik, dietës së shëndetshme dhe gjumit të mjaftueshëm. Mbajtja e një stili jetese të shëndetshëm ju jep energjinë dhe fokusin që ju nevojitet për të pasur sukses në shkollë!

## Kërkoni ndihmë

Asnjëherë mos hezitoni të kërkoni ndihmë kur ju nevojitet. Mësimnxënësit, prindërit, bashkëmoshatarët dhe të tjerët mund t'ju japin mbështetje dhe

# CHALLENGES AND OPPORTUNITIES BROUGHT BY SEPTEMBER AND NEW SCHOOL YEAR



*Unwritten notebooks, colorful pencils, the smell of new books and the air of excitement - these are some of the characteristic elements that mark the beginning of a new school year. As the sun slowly gets weaker, the students face new challenges, but also opportunities for growth and development. School is a place where they gain knowledge, build friendships and shape their future paths. In this article, we will explore some of the most common challenges that you, our dear readers, face at the beginning of the new school year, as well as how to bravely overcome them...*

*shpjegime shtesë për detyrat e shkollës. Mësoni të bëni pyetje dhe të kërkoni ndihmë në mënyrë aktive sa herë që ju nevojitet.*

### Ekuilibri në mes të shkollës dhe pushimit

*Është e rëndësishme të gjeni ekuilibër në mes të detyrave të shkollës dhe kohës së lirë. Ju duhet të ndani kohë për pushim, hobi dhe aktivitete shoqërore për ta shmangur dërrmimin dhe për ta mbajtur një ekuilibër të mirë mendor.*

### Qëndrimi pozitiv

*Është e rëndësishme që ta mbani një qëndrim pozitiv lidhur me mësimnxënien dhe sfidat e reja. Besimi në aftësitë tuaja dhe optimizmi mund të jenë faktorët kyç që do t'ju motivojnë dhe do ta ndërtojnë vetëbesimin tuaj.*

*Me pak fjalë, fillimi i vitit të ri shkollor ju sjell shumë mundësi për rritje dhe zhvillim. Me menaxhimin e mirë të kohës, vendosjen e caqeve, përdorimin e teknikave efektive të të nxënit, kujdesin për shëndetin tuaj, kërkimin e ndihmës dhe ruajtjen e ekuilibrit në mes të punës dhe kohës së lirë, mund të arrini sukses dhe ta mbërrini potencialin tuaj të plotë. Qoftë ky viti shkollor kur i mbërrini caqet tuaja, fitoni njohuri të reja dhe përvoja të paharrueshme! Dhe sigurisht ne ju urojmë shumë pesëshe, dhe për çdo mëdyshje dhe problem që hasni, na shkruani në magazineforyou2003@gmail.com!*

*September is already here, the new school year has started, many of you are excited, maybe even a little nervous about the changes it brings. In order to be best prepared and to succeed in the coming months, it is important to keep a few practical tips in mind. You have probably already heard them a million times from your teachers, professors and parents, but we are also here to repeat the most valuable advice that will help you face the new school year in the best possible way and use all your potentials for better learning and greater achievements in school.*

### Time management

*One of the key factors for success at school is good time management. Create a schedule of daily activities including the time for studying, exercising, rest, and other responsibilities. Planning helps maintain focus and prevent stress.*

### Goal setting

*As the new school year begins, set realistic goals for each subject or field you wish to improve. Defining goals helps keep you motivated and steers you towards making progress.*

### Effective learning techniques

*Every student has their own way of studying that suits them best. It is important to explore different learning techniques such as note-taking, using visual aids, group learning, etc. Find out which technique best suits your learning style and apply it to effectively learn the curriculum.*

### Healthy lifestyle

*Physical and mental health are essential to success at school. Take care of your health through regular physical activity, a healthy diet and enough sleep. Maintaining a healthy lifestyle gives you the energy and focus you need to succeed in school!*

### Asking for help

*Never hesitate to ask for help when you need it. Teachers, parents, peers and others can give you additional support and explanations of the schoolwork. Learn to ask questions and actively seek help whenever you need it.*

### Balance between school and leisure

*It is important to find balance between schoolwork and leisure. You need to set aside time for rest, hobbies and social activities to avoid burnout and maintain a good mental balance.*

### A positive attitude

*It is important to maintain a positive attitude towards studying and new challenges. Believing in your own ability and optimism can be key factors that will motivate you and build your self-confidence.*

*In short, the beginning of a new school year brings you many opportunities for growth and development. With good time management, setting goals, using effective study techniques, taking care of your health, seeking help, and maintaining a balance between work and free time, you can achieve success and reach your full potential. May this school year be a time for achieving your goals, acquiring new knowledge and unforgettable experiences! And of course we wish you lots of A's, and for any doubts and problems you face, write to us at magazineforyou2003@gmail.com!*

Brain teasers

# FJALËKRYQ SKANDINAV



AKTORI I NJOHUR KANADEZ NGA FOTO

QË LIDHET ME KAUKAZIN APO KAUKAZIANËT

R. G.

TRI ZANORE

TË QENËT VIRTUAL (SH. P.)

DYSHET, ÇIFTET

SHIGJETËZA E ORËS

LLOJ MACEJE E EGËR, JETON NË AMER.(J.)

SIMBOLI KIMIK I ARIT

ZË I THELLË (MUZ.)

I MORALSHËM

N. K. E.

DY ZANORE

IVAN LENDL

GATOVA, PËRGATITA

ISHFUTBOLLISTI TURKO-GJERMAN, MESUT

LITËR

DIÇKA QË RRJEDH NGA DIÇ TJETËR

PËRFAQËSUES I NJË POPULLI NË INDI

KAM NJOHURI

GOVATA

NOTË MUZIKORE

EMËR (M.) HUAJ

FEMËR E DASHIT

QË KA TË BËJË ME INDET

NUMRAT "NATYRAL"

EMËR (M.)

QË NISET VETËM NGA DOBIA PRAKTIKE

LLOJ PIJE ALKOOLIKE

QENGJ I BUTË QË ËSHTË MËSUAR T'I SHKOJË BARIUT PAS

SHEGË

LËNDË SHPËRTHYESE (SH. SH.)

BARDHË (TURQ.)

AKTORI I NJOHUR KROAT, ANTUN

SULMIM, MËSYMJE

ZOG ROSE, BIBË ROSE (SHQ.)

PERSONAZH NGA SATIRA E XHONATAN SUIFTIT

SHKRONJË E GREQISHTES

TRISKË, KUPON UDHËTIMI (SH. SH.)

EKZEMPLARI I VETËM

THIRRJE, GRISHJE

PARAFJALË GREKE ME DOMETHËNIE DY

PRIJËS I KOZAKËVE

PRONË NËN SUNDIMIN E EMIRIT

KTHESË

GYPI NËPËR TË CILIN QARKULLON GJAKU

NJË PYETËSE (POL.)

IGI POP

HYJNI DASHURIE NË ROMËN E LASHTË

LUMË NË MAQED. E VERIUT

ZË

KRYEQYTETI I PERUSË

EDHE (LAT.)

NJËSI E VJETËR PESHE (SH.)

LLOJ FILXHANI

GANIMETE (DEMIN.)

KOHË E CAKTUAR E PUNËS

NJOHËS I ETIMOLOGJISË

1000 (ROM)

SHKRUAJ D. A. V.

MOLIBDEN

EMËR FEMRE (ELIZABET)

LOJË BIXHOZI ME LETRA

TENISTI SPANJOLL, RAFAEL

TELUR

NUMRAT "REAL"

T. O.

VEPËR E SHKRIMT. LAJOSH ZILAHI

AEROPORTI I TOKIOS

50 (ROM.)

VIT I RI KINEZ

TV APARATI (PASHQ.)

Let's learn TOGETHER!

# Sërish në shkollë
# Ponovo u školi


Dreni


Jelena

## Fjalor - Rečnik

| | |
|---|---|
| Javë | Nedelja |
| Shkollë | Škola |
| Shoqëri | Društvo |
| Ndjenjë/a | Osećaj/nja |
| Arsimtar/e | Nastavnik/ica |
| Mësues/e | Učitelj/ica |
| Lëndë shkollore | Školski predmet |
| Mësoj | Učim |
| Numër | Broj |
| Shkronjë | Slovo |
| Fjalë | Reč |
| Fjali | Rečenica |
| Klasë | Razred |
| Bankë shkollore | Školska klupa |
| Çantë shkollore | Školska tašna (Ranac) |
| Libër | Knjiga |
| Fletore | Sveska |
| Laps | Olovka |
| Stilolaps | Hemijska olovka |
| Gomë për fshirje | Gumica za brisanje |
| Mprehëse për lapsa | Rezač za olovke |
| Vizore | Lenjir |
| Mbajtëse e lapsave | Držač za olovke |
| Nxënës/e | Učenik/ica |
| Detyrat e shtëpisë | Domaći zadatak |
| Tabelë e shkollës | Školska tabla |
| Shkumës | Kreda |
| Shpuzë | Sunđer |



Did you know?



"Arsimi është pasaporta drejt së ardhmes. Sepse e nesërmja iu takon atyre që përgatiten sot për të."

***- Malcolm X***

**Për foto të tjera, skanoje QR kodin**